FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2026 – Numri: 107

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 26 maj 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 46/2026, datë 23.4.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33/2021 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.....	9487
Dekret i Presidentit nr. 316, datë 15.5.2026	Për shpallje ligji.....	9489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 20.5.2026	Për përcaktimin e rregullave për pagesat e shërbimeve të ofruara nga shoqëria "*Albanian Digital Solution*" sh.a. ndaj institucioneve publike përfituese.....	9489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 370, datë 20.5.2026	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të disa pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat kadastrale 3866 dhe 2105, Kashar, Bashkia Tiranë.....	9498
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 20.5.2026	Për përcaktimin e mënyrës së organizimit e të funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit e të akuakulturës dhe për miratimin e formës e të përmbajtjes së planeve të prodhimit e të marketingut.....	9550
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 373, datë 20.5.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar.....	9563
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 271, datë 20.5.2026	Për delegimin e autoritetit/kompetencave nëpunësve të lartë civilë të Ministrisë së Drejtësisë.....	9564
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 17, datë 19.5.2026	Për anëtarësimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë "Dega e Bankës Türkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" në skemën e sigurimit të depozitave dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave.....	9565

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 100/10, datë 20.5.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i linjës 110 kV Fier–Kafaraj dhe vendosja e traktit të ri në nënstacionin Fier".....	9565
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (nr. 11-2026-2363) 468, datë 17.4.2026	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sotir Papaspiro.....	9572
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Leonard Gockaj.....	9572

LIGJ
Nr. 46/2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 33/2021, "PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 33/2021, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 6, pika 1, pas fjalës "drejtorie" shtohet fjala "njësie".

Neni 2

Në nenin 17 bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës emërohet nga Kryeministri me propozim të ministrit dhe i jepet grada "Drejtues madhor". Ai përzgjidhet nga radhët e punonjësve të Gardës që mbajnë gradën "Drejtues i Parë/Drejtues i Lartë.".

2. Fjalia e parë, e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Drejtori i përgjithshëm duhet të përmbushë këto kritere:".

3. Shkronjat "d" dhe "dh", të pikës 2 shfuqizohen.

4. Shkronja "e" ndryshohet si më poshtë:

"e) të mos jetë larguar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore brenda 3 vjetëve të fundit;".

Neni 3

Në nenin 19 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshohet duke hequr togfjalëshin "dhe drejtorët e drejtorive".

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Zëvendësdrejtori emërohet nga ministri, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Gardës. Ai zgjidhet nga punonjësit e Gardës që mbajnë gradën "Drejtues i parë". Në momentin e emërimit zëvendësdrejtori merr gradën "Drejtues i Lartë".".

3. Në pikën 4, pas fjalës "drejtorit" shtohet fjala "të përgjithshëm".

4. Pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

5. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

"4/1. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm rimerr gradën "Drejtues i Parë" kur transferohet në një funksion tjetër.".

Neni 4

Pika 3 e nenit 21 shfuqizohet.

Neni 5

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23
Pranimi i punonjësve nga fushat e tjera të sigurisë

1. Për plotësimin e nevojave të identifikuara për rekrutimin e punonjësve me gradën "Inspektor" deri "Komisar" mund të pranohen në Gardën e Republikës edhe punonjës nga fushat e tjera të sigurisë, që plotësojnë kriteret e pikës 1, të nenit 21 të këtij ligji dhe janë deri në moshën 40 vjeç.

2. Pranimi realizohet mbi baza konkurrimi, procedurat e të cilit përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

3. Kalimi nga këto struktura në Gardën e Republikës realizohet duke ruajtur dhe njohur vjetërsinë e shërbimit.

4. Procedurat, rregullat dhe mënyra e ekuivalentimit të gradave për punonjësit nga fushat e tjera të sigurisë me ato të Gardës së Republikës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 6

Në nenin 28, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Kohëzgjatja e transferimit zgjat si rregull deri në 6 muaj, por jo më shumë se 1 (një) vit.".

Neni 7

Në nenin 29 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja "b", e pikës 1, ndryshon si më poshtë:

"b) merret njoftim nga organet ligjzbatuese që ka kryer veprime që cenojnë dinjitetin ose integritetin e institucionit, të përcaktuara në rregulloren e Gardës së Republikës.".

2. Pas shkronjës "b", të pikës 1, shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) ka filluar hetimi për shkelje të rënda disiplinore nga struktura përgjegjëse në Gardën e Republikës.".

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Pezullimi nga detyra për shkaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni zgjat për aq kohë sa proceset të marrin formë të prerë.".

Neni 8

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 30
Ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe rikthimi

1. Punonjësi i Gardës ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet nga strukturat e Gardës.

2. Punonjësi lirohet, kur:

a) mbush moshën për pension pleqërie;

b) deklarohet i paaftë për punë nga organi kompetent mjekësor;

c) i miratohet kërkesa për lirim;

ç) lë shtetësinë shqiptare;

d) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjykate;

dh) bëhen shkurtime në funksionet organike dhe në numrin e përgjithshëm të punonjësve;

e) ka vlerësime të performancës në punë dhe të rezultateve të testimeve të nivelit nën mesatar për 2 (dy) herë rresht.

3. Punonjësi përjashtohet, kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) shkel betimin;

c) cenon rëndë integritetin e institucionit;

ç) nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të justifikuara për më shumë se 7 (shtatë) ditë pune;

d) ka konsumuar të gjitha masat disiplinore të parashikuara.

4. Një punonjësi të liruar sipas shkronjave "c" dhe "dh", të pikës 2 të këtij neni i lind e drejta të konkurrojë për t'u rikthyer në strukturat e Gardës kur krijohen vende të lira.

5. Rregullat dhe procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe rikthimit përcaktohen në rregulloren e Gardës.".

Neni 9

Në nenin 37 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronjat "c", "ç" dhe "dh", ndryshojnë si më poshtë:

"c) nga "nënkomisar" në "komisar" 5 vjet;

ç) nga "komisar" në "kryekomisar" 5 vjet;

dh) nga "drejtues" në "drejtues i parë"5 vjet.".

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Kur lind nevoja për plotësimin e vendeve vakante, hapet konkurrimi për gradën "nënkomisar" nga punonjësit e Gardës të nivelit bazë, që kanë vjetërsi shërbimi mbi 5 (pesë) vjet dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve të arsimit të lartë, duke zbatuar të njëjtat rregulla dhe procedura konkurrimi si për fitimin e gradave të tjera.".

Neni 10

Në nenin 38, pika 1, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "b/1" me këtë përmbajtje:

"b/1) për gradën nënkomisar të ketë përfunduar kursin e trajnimit për nënkomisar;".

Neni 11

Neni 39 ndryshon si më poshtë:

"Neni 39
Dhënia dhe fitimi i gradës

1. Gradat nga "inspektor i dytë" deri "drejtues i parë" fitohen nëpërmjet konkurrimit për gradë.

2. Gradat "drejtues i lartë" dhe "drejtues madhor" jepen për shkak të funksionit.

3. Grada "inspektor" jepet pas përfundimit të shkollimit bazë.

4. Grada "nënkomisar" jepet pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve të arsimit të lartë në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, ose në institucione të tjera të arsimit të lartë të njësuara me të, brenda e jashtë vendit.

5. Komisionet e gradimeve ngrihen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës.

6. Rregullat dhe procedurat e zhvillimit të procesit të konkurrimit për gradë përcaktohen në rregulloren e Gardës së Republikës.".

Neni 12

Në nenin 40, pika 1, fjala "komisar" zëvendësohet me fjalën "nënkomisar".

Neni 13

Në nenin 41 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

"1. Për fitimin e gradës "nënkomisar" deri "kryekomisar" kandidati vlerësohet në testimin fizik e profesional dhe intervistën me gojë.".

2. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

"2. Për fitimin e gradës "drejtues" dhe "drejtues i parë" kandidati vlerësohet në testimin profesional, me ushtrime vlerësuese dhe intervista me gojë.".

3. Pas pikës 2, shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

"2/1. Për fitimin e gradës "inspektor i dytë" kandidati vlerësohet në testimin fizik e profesional.

2/2. Për fitimin e gradës "inspektor i parë" kandidati vlerësohet në testimin profesional.".

Neni 14

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 23, pika 4, të këtij ligji.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.4.2026.

Shpallur me dekretin nr. 316, datë 15.5.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 316, datë 15.5.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 46/2026, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33/2021, 'Për Gardën e Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar"'.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 369, datë 20.5.2026

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PAGESAT E SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA SHOQËRIA "*ALBANIAN DIGITAL SOLUTION*" SHA NDAJ INSTITUCIONEVE PUBLIKE PËRFITUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 36, të ligjit nr. 43/2023, "Për qeverisjen elektronike", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave, të parimeve, të procedurës dhe të metodologjisë për llogaritjen e pagesave që kryejnë institucionet publike përfituese ndaj shoqërisë "*Albanian Digital Solution*" sh.a., për shërbimet në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit (në vijim "TIK"), si dhe të

implementimit të masave të sigurisë kibernetike, të ofruara në bazë të kontratave të shërbimit dhe/ose marrëveshjeve të nivelit të shërbimit.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky vendim zbatohet për shërbimet TIK dhe shërbimet e implementimit të masave të sigurisë kibernetike, që ofrohen nga shoqëria "*Albanian Digital Solution*" sh.a., (në vijim, shoqëria "ADS" sh.a.), ndaj institucioneve publike përfituese, në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj dhe legjislacionin në fuqi.

2. Për qëllim të këtij vendimi, institucione publike përfituese konsiderohen institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe institucione të tjera publike, të cilat përfitojnë këto shërbime me kërkesë të vetë institucionit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për qeverisjen elektronike.

Neni 3
Natyra juridike e pagesave

1. Pagesat që kryejnë institucionet publike përfituese ndaj shoqërisë "ADS" sh.a., për shërbimet e ofruara në bazë të kontratave të shërbimit dhe/ose marrëveshjeve të nivelit të shërbimit, nuk përbëjnë tarifa publike.

2. Këto pagesa kanë natyrën e pagesave kontraktore për shërbime TIK dhe shërbime të implementimit të masave të sigurisë kibernetike dhe përcaktohen në përputhje me këtë vendim, metodologjinë bashkëlidhur tij, si dhe kontratën përkatëse të shërbimit.

Neni 4
Llojet e shërbimeve

1. Shërbimet që ofron shoqëria "ADS" sh.a., në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj dhe legjislacionin në fuqi, ndahen në tri grupe kryesore:

a)shërbime të zhvillimit, të përmirësimit e të integrimit të sistemeve, platformave, aplikacioneve dhe moduleve TIK, të cilat përfshijnë, ndër të tjera: zhvillimin e sistemeve, të platformave dhe të aplikacioneve të reja; përmirësimin, zgjerimin, modernizimin dhe migrimin e sistemeve ekzistuese; integrimin e sistemeve dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave; analizën, projektimin dhe arkitekturën e zgjidhjeve teknike;

b) shërbime të administrimit teknik, operimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve, platformave dhe infrastrukturave TIK, të cilat përfshijnë, ndër të tjera: administrimin teknik dhe operimin e vazhdueshëm të sistemeve dhe infrastrukturave TIK; mirëmbajtjen e tyre; monitorimin teknik dhe operacional; mbështetjen teknike e funksionale; menaxhimin e incidenteve teknike dhe rikuperimin e shërbimit; garantimin e disponueshmërisë, performancës dhe vazhdimësisë operacionale;

c) shërbime të implementimit të masave të sigurisë kibernetike, në kuadër të operimit dhe administrimit të sistemeve TIK, të cilat përfshijnë, ndër të tjera: mbrojtjen, monitorimin, forcimin, vlerësimin, auditimin, testimin, përmirësimin, menaxhimin e riskut, si dhe mbështetjen për qeverisjen, pajtueshmërinë dhe zbatimin e masave të sigurisë për rrjetet, sistemet, platformat, aplikacionet dhe infrastrukturat TIK; parandalimin, identifikimin, analizimin e trajtimin e ngjarjeve apo të incidenteve të sigurisë kibernetike; si dhe shërbime të tjera specifike të fushës së sigurisë kibernetike, në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë "ADS" sh.a. dhe legjislacionin në fuqi.

2. Ofrimi i shërbimeve të implementimit të masave të sigurisë kibernetike kryhet nga shoqëria "ADS" sh.a., në rolin e implementuesit dhe ka natyrë teknike, operacionale dhe mbështetëse, pa cenuar kompetencat rregullatore, mbikëqyrëse, inspektuese ose certifikuese të autoriteteve përgjegjëse për sigurinë kibernetike, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Listimi i shërbimeve në këtë nen nuk është shterues dhe nuk kufizon shoqërinë "ADS" sh.a. në ofrimin e shërbimeve të tjera të lidhura me zhvillimin, administrimin teknik, operimin, mirëmbajtjen, përmirësimin, sigurinë, integrimin ose transformimin digjital të sistemeve, platformave, aplikacioneve, infrastrukturave dhe shërbimeve elektronike, në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj dhe legjislacionin në fuqi.

4. Shërbimet që do të ofrohen përcaktohen në kontratën e shërbimit dhe/ose marrëveshjen e nivelit të shërbimit ndërmjet palëve.

Neni 5
Parimet për përcaktimin e pagesave

Pagesat për shërbimet e ofruara nga shoqëria "ADS" sh.a. përcaktohen në përputhje me këto parime:

a) Transparenca në përllogaritjen e komponentëve kryesorë të kostos;

b) Lidhja e pagesës me natyrën, volumin, kompleksitetin dhe kritikalitetin e shërbimit;

c) Përdorimi efikas i burimeve publike;

ç) Standardizimi i modelit dhe i metodologjisë së pagesave për shërbime të ngjashme;

d) Garantimi i qëndrueshmërisë financiare dhe operacionale të shoqërisë, nëpërmjet aplikimit të një marzhi operacional të arsyeshëm mbi kostot e shërbimit;

dh) Proporcionaliteti i pagesës me angazhimin real të burimeve njerëzore, teknike dhe teknologjike;

e) Fleksibiliteti në përcaktimin e pagesës rast pas rasti, sipas specifikave të çdo shërbimi.

KREU II
METODOLOGJIA, KLASIFIKIMI DHE MARZHI OPERACIONAL

Neni 6
Metodologjia e llogaritjes së pagesave

1. Pagesat për shërbimet e ofruara nga shoqëria "ADS" sh.a. llogariten mbi bazën e metodologjisë së përcaktuar në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për llogaritjen e pagesës konkrete për çdo shërbim, shoqëria "ADS" sh.a. vlerëson komponentët e kostos dhe faktorët teknikë, funksionalë, operacionalë dhe financiarë, që lidhen me natyrën, objektin, kompleksitetin, kohëzgjatjen dhe nivelin e kërkuar të shërbimit.

3. Komponentët dhe faktorët, që merren në konsideratë për llogaritjen e pagesës, përfshijnë, sipas natyrës së shërbimit:

a) kostot e burimeve njerëzore të brendshme ose të ekspertizës së jashtme të angazhuar për ofrimin e shërbimit, përfshirë pagesat, shtesat ose shpërblimet e lidhura drejtpërdrejt me angazhimin në shërbim, sipas akteve të brendshme të shoqërisë "ADS" sh.a.;

b) kostot e licencave, platformave, mjeteve, aplikacioneve dhe teknologjive të nevojshme;

c) kostot e infrastrukturës, hostimit, ruajtjes së të dhënave, *backup*-it, rikuperimit, vazhdimësisë dhe disponueshmërisë së shërbimit;

ç) kostot administrative, organizative dhe të menaxhimit të shërbimit;

d) kostot specifike të sigurisë kibernetike;

dh) kostot për trajnimin, orientimin ose transferimin e njohurive të përdoruesit dhe strukturat përgjegjëse të institucionit përfitues;

e) kompleksitetin teknik e funksional të sistemit, platformës, aplikacionit, infrastrukturës ose shërbimit;

ë) kritikalitetin dhe ndikimin e shërbimit në funksionimin institucional ose në ofrimin e shërbimeve publike;

f) nivelin e kërkuar të disponueshmërisë, sigurisë, performancës, mbështetjes dhe vazhdimësisë;

g) volumin e përdoruesve, transaksioneve, integrimeve, ndërveprimeve dhe të të dhënave të përpunuara;

gj) nevojën për zhvillime të reja, përmirësime funksionale, mirëmbajtje evolutive, migrim, integrim ose optimizim;

h) kohëzgjatjen e angazhimit, afatet e kërkuara dhe burimet e nevojshme për realizimin e shërbimit;

i) marzhin operacional për qëndrueshmëri financiare, risk operacional dhe rritje të kapaciteteve;

j) çdo element tjetër kostoje, i nevojshëm dhe i arsyetuar, që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë nen, por që lidhet drejtpërdrejt me ofrimin, garantimin, përmirësimin, sigurinë ose vazhdimësinë e shërbimit.

4. Në përcaktimin e kostimit të shërbimit, shoqëria "ADS" sh.a. mban në konsideratë, kur është e mundur dhe e përshtatshme, çmimet e tregut për shërbime të ngjashme ose të krahasueshme, me qëllim shmangien e diferencave të pajustifikuara. Ky krahasim ka karakter orientues dhe kryhet duke marrë në konsideratë natyrën, objektin, kompleksitetin, nivelin e shërbimit, afatet, burimet e angazhuara, kërkesat e sigurisë, vazhdimësinë operacionale dhe kushtet konkrete të realizimit të shërbimit.

Neni 7
Klasifikimi i shërbimeve

1. Për efekt të përcaktimit të pagesës dhe aplikimit të marzhit operacional, shërbimet e ofruara nga shoqëria "ADS" sh.a. klasifikohen mbi bazën e

ndërthurjes së kategorisë financiare të shërbimit, të përcaktuar sipas vlerës totale të tij, me nivelin e kompleksitetit të shërbimit, të përcaktuar sipas metodologjisë së parashikuar në këtë vendim dhe në aneksin nr. 1 bashkëlidhur tij.

2. Kategoritë e klasifikimit, sipas vlerës financiare të shërbimit, janë:

a) Kategoria I – shërbime me vlerë deri në 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) lekë;

b) Kategoria II – shërbime me vlerë mbi 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) lekë deri në 150.000.000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

c) Kategoria III – shërbime me vlerë mbi 150.000.000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë deri në 350.000.000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

ç) Kategoria IV – shërbime me vlerë mbi 350.000.000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

3. Niveli i kompleksitetit të shërbimit klasifikohet në katër nivele:

a) I ulët – shërbime rutinë, mirëmbajtje standarde ose ndërhyrje të kufizuara teknike;

b) Mesatar – shërbime, që përfshijnë integrime të moderuara, zhvillime ose përmirësime funksionale të kufizuara apo ndërhyrje në sisteme ekzistuese;

c) I lartë – shërbime që përfshijnë integrime komplekse, migrim, arkitekturë të re teknike, zhvillime të rëndësishme ose sisteme me ndikim të lartë institucional;

ç) Shumë i lartë – shërbime që lidhen me sisteme, platforma ose infrastruktura TIK me ndikim të lartë institucional, operacional ose publik, me kërkesa të larta për vazhdimësi, siguri, disponueshmëri, ose me transformim digjital në shkallë të gjerë.

4. Klasifikimi sipas vlerës financiare të pikës 2 të këtij neni dhe nivelit të kompleksitetit të pikës 3 të këtij neni shërben si bazë për përcaktimin e marzhit operacional të aplikueshëm, sipas matricës së parashikuar në nenin 8 të këtij vendimi.

5. Kategoritë financiare të pikës 2 të këtij neni dhe nivelet e kompleksitetit të pikës 3 të këtij neni janë të pavarura nga njëra-tjetra. Vlera e lartë financiare e shërbimit nuk nënkupton domosdoshmërish kompleksitet të lartë, dhe anasjelltas. Marzhi operacional aplikohet sipas kryqëzimit të të dy faktorëve.

6. Metodologjia për përcaktimin e nivelit të kompleksitetit hartohet e miratohet nga shoqëria "ADS" sh.a. Kjo metodologji shërben për përcaktimin e nivelit të kompleksitetit të shërbimit për efekt të aplikimit të matricës së marzhit operacional, pa ndryshuar kategoritë financiare, nivelet e kompleksitetit dhe përqindjet e marzhit, të përcaktuara në këtë vendim.

Neni 8

Marzhi operacional

1. Për çdo shërbim të ofruar, shoqëria "ADS" sh.a. aplikon një marzh operacional mbi kostot e shërbimit, që realizohet drejtpërdrejt prej saj. Marzhi operacional përcaktohet sipas matricës, që ndërthur kategorinë e vlerës financiare të shërbimit, të përcaktuar mbi bazën e vlerës totale të tij, me nivelin e kompleksitetit të shërbimit, në përputhje me nenin 7 të këtij vendimi dhe aneksin nr. 1 bashkëlidhur tij.

2. Marzhi operacional aplikohet si përqindje fikse, sipas matricës që ndërthur kategorinë e vlerës financiare të shërbimit me nivelin e kompleksitetit, në përputhje me nenin 7 të këtij vendimi:

Kategoria/kompleksiteti	I ulët	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë
Kategoria I (deri në 50 milionë lekë)	**8%**	**10%**	**13%**	**16%**
Kategoria II (50–150 milionë lekë)	**7%**	**9%**	**12%**	**15%**
Kategoria III (150–350 milionë lekë)	**6%**	**8%**	**11%**	**14%**
Kategoria IV (mbi 350 milionë lekë)	**5%**	**7%**	**10%**	**13%**

3. Për shërbimet e implementimit të masave të sigurisë kibernetike, kur ato përbëjnë objektin kryesor të shërbimit ose ofrohen si shërbime të specializuara të sigurisë kibernetike, aplikohet marzh operacional fiks prej 20%.

4. Marzhi operacional, sipas matricës së pikës 2 të këtij neni, reflekton tendencë zbritëse me rritjen e vlerës financiare të shërbimit, në përputhje me parimin e përdorimit efikas të burimeve publike dhe shmangies së fitimeve disproporcionale, si dhe tendencë rritëse me rritjen e nivelit të kompleksitetit, sipas natyrës dhe përmasës reale të shërbimit. Marzhi operacional për shërbimet e implementimit të masave të sigurisë kibernetike përcaktohet si

marzh fiks, për shkak të natyrës së specializuar, riskut operacional dhe kërkesave të veçanta teknike të këtyre shërbimeve.

5. Marzhi operacional nuk aplikohet mbi vlerën e mallrave, pajisjeve *hardware*, licencave *software*, platformave, produkteve, teknologjive, abonimeve ose shërbimeve të tjera të palëve të treta, të cilat sigurohen për realizimin e shërbimit. Këto kosto përfshihen në kostimin e shërbimit si zëra të veçantë, pa marzh operacional të shtuar.

6. Kur elementet e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni janë objekt i procedurave të prokurimit publik, vlera e tyre përcaktohet e dokumentohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

KREU III
PROCEDURA E PARAQITJES DHE E TRAJTIMIT TË KËRKESËS

Neni 9
Paraqitja, vlerësimi dhe trajtimi i kërkesave

1. Institucionet publike, për realizimin e projekteve për zhvillimin, përmirësimin, mirëmbajtjen, operimin ose implementimin e masave të sigurisë kibernetike të sistemeve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, kanë detyrimin të paraqesin kërkesat përkatëse pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në përputhje me legjislacionin në fuqi për qeverisjen elektronike.

2. AKSHI shqyrton paraprakisht kërkesën e paraqitur dhe, në bashkëpunim me institucionin kërkues, harton kërkesa teknike dhe funksionale, si dhe miraton termat e referencës ose dokumentin përkatës të specifikimit të shërbimit.

3. Pas miratimit të termave të referencës ose të dokumentit përkatës të specifikimit të shërbimit, AKSHI ia përcjell kërkesën dhe dokumentacionin përkatës shoqërisë "ADS" sh.a., për vlerësimin e mundësisë së realizimit të shërbimit.

4. Shoqëria "ADS" sh.a., brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga marrja e kërkesës së plotë dhe dokumentacionit përkatës nga AKSHI, kryen vlerësimin paraprak të kërkesës dhe shprehet me akt të arsyetuar me shkrim mbi mundësinë ose pamundësinë e realizimit të shërbimit të kërkuar, duke vlerësuar natyrën e shërbimit, përputhshmërinë me objektin e veprimtarisë së saj, kapacitetet teknike dhe njerëzore, burimet e nevojshme, afatet, kushtet e realizimit dhe çdo element tjetër të rëndësishëm për ofrimin e shërbimit.

5. Në rast se shoqëria "ADS" sh.a. vlerëson se nuk mund ta realizojë shërbimin e kërkuar, ajo njofton AKSHI-n me akt të arsyetuar me shkrim, duke evidentuar shkaqet e pamundësisë së realizimit. AKSHI njofton institucionin publik kërkues për vijimin e procedurave përkatëse.

6. Në rastet kur shërbimi nuk mund të ofrohet nga shoqëria "ADS" sh.a., institucioni publik kërkues mund të vijojë me sigurimin e shërbimit nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Në rast se shoqëria "ADS" sh.a. vlerëson se shërbimi mund të realizohet prej saj, ajo kryen analizën e detajuar të shërbimit, brenda një afati deri në 20 (njëzet) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit paraprak. Analiza e detajuar përfshin analizën funksionale, teknike dhe operacionale të kërkesës, përllogaritjen e vlerës totale të shërbimit, përcaktimin e nivelit të kompleksitetit, klasifikimin e shërbimit në kategorinë financiare përkatëse, kostimin e detajuar, aplikimin e marzhit operacional sipas nenit 8 të këtij vendimi dhe përcaktimin e pagesës së shërbimit.

8. Në rast se gjatë analizës së detajuar shoqëria "ADS" sh.a. konstaton se dokumentacioni i përcjellë nuk është i plotë ose kërkon saktësime, ajo i kërkon AKSHI-t plotësimin ose sqarimin e tij. AKSHI, në bashkëpunim me institucionin publik kërkues, përcjell dokumentacionin ose sqarimet e nevojshme brenda 7 (shtatë) ditëve punë nga marrja e kërkesës nga shoqëria "ADS" sh.a. Afatet e përcaktuara në këtë nen për shoqërinë "ADS" sh.a. pezullohen deri në marrjen e dokumentacionit ose të sqarimeve të nevojshme.

9. Pas përfundimit të analizës së detajuar, shoqëria "ADS" sh.a. i përcjell AKSHI-t kostimin e shërbimit, pagesën e përllogaritur, komponentët kryesorë të kostos, si dhe kushtet e nevojshme për realizimin e shërbimit. AKSHI ia përcjell dokumentacionin institucionit publik kërkues për konfirmimin e vijimit të procedurës dhe të fondeve të nevojshme.

10. Kur realizimi i shërbimit kërkon sigurimin e mallrave, licencave, platformave, pajisjeve, teknologjive, shërbimeve mbështetëse ose komponentëve të tjerë, që nuk ofrohen drejtpërdrejt

nga shoqëria "ADS" sh.a., kostot përkatëse evidentohen veçmas në analizën e detajuar dhe në kostimin e shërbimit. Kur këto elemente janë objekt i procedurave të prokurimit publik, vlera e tyre përcaktohet si fond limit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

11. Institucioni publik kërkues konfirmon, nëpërmjet AKSHI-t, vijimin e procedurës, disponueshmërinë e fondeve të nevojshme dhe dakordësinë për lidhjen e kontratës së shërbimit dhe/ose të marrëveshjes së nivelit të shërbimit me shoqërinë "ADS" sh.a. Pas këtij konfirmimi, palët vijojnë me lidhjen e kontratës së shërbimit dhe/ose marrëveshjes së nivelit të shërbimit, si dhe, sipas rastit, me procedurat për sigurimin e elementeve të nevojshme për realizimin e shërbimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10
Kontrata e shërbimit dhe marrëveshja e nivelit të shërbimit

1. Marrëdhënia ndërmjet shoqërisë "ADS" sh.a. dhe institucionit publik përfitues rregullohet nëpërmjet kontratës së shërbimit dhe/ose marrëveshjes së nivelit të shërbimit.

2. Kontrata e shërbimit dhe/ose marrëveshja e nivelit të shërbimit përmban, të paktën, elementet e mëposhtme:

a) Palët, objektin dhe fushën e shërbimit;

b) Llojin dhe kategorinë e shërbimit, sipas nenit 7 të këtij vendimi;

c) Nivelin e shërbimit, afatet dhe treguesit kryesorë të performancës;

ç) Përgjegjësitë dhe detyrimet e palëve;

d) Mënyrën e raportimit, monitorimit e pranimit të shërbimit;

dh) Pagesën përkatëse, afatet dhe kushtet e pagesës;

e) Zërat e kostos, që lidhen me elemente të siguruara nga palë të treta, kur ka të tilla;

ë) Kushtet për rishikimin e pagesës;

f) Kërkesat për sigurinë, konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave dhe vazhdimësinë e shërbimit;

g) Çdo element tjetër të nevojshëm, sipas natyrës dhe kompleksitetit të shërbimit.

3. Kontrata e shërbimit dhe/ose marrëveshja e nivelit të shërbimit lidhet ndërmjet shoqërisë "ADS" sh.a., AKSHI-t dhe institucionit publik përfitues.

Neni 11
Pronësia dhe përgjegjësia mbi sistemet dhe të dhënat

Ofrimi i shërbimeve nga shoqëria "ADS" sh.a., sipas këtij vendimi, nuk ndryshon pronësinë mbi sistemet, platformat, infrastrukturat, bazat e të dhënave ose të dhënat, që administrohen nga institucionet publike përfituese, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj ose me akt të posaçëm.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 12
Kontratat ekzistuese

1. Kontratat ekzistuese të lidhura ndërmjet AKSHI-t, institucioneve publike dhe operatorëve ekonomikë për ofrimin e shërbimeve të zhvillimit, përmirësimit, mirëmbajtjes, operimit, mbështetjes teknike ose shërbimeve të tjera të lidhura me sistemet TIK vijojnë të zbatohen sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në to.

2. Pas përfundimit të afatit të kontratave ekzistuese ose në rastet kur kontratat ndryshohen, zëvendësohen ose përfundojnë përpara afatit, ofrimi i shërbimeve përkatëse trajtohet në përputhje me parashikimet e këtij vendimi dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 13
Zbatimi dhe hyrja në fuqi

Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, shoqëria "*Albanian Digital Solution*" sh.a., institucionet publike përfituese dhe institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

ANEKS NR. 1

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E PAGESAVE TË SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA SHOQËRIA "*ALBANIAN DIGITAL SOLUTION*" SHA

1. Qëllimi

Kjo metodologji përcakton mënyrën e llogaritjes së pagesave për shërbimet që ofrohen nga shoqëria "*Albanian Digital Solution*" sh.a. (në vijim, shoqëria "ADS" sh.a.), ndaj institucioneve publike përfituese.

Metodologjia ka për qëllim të sigurojë që pagesa për çdo shërbim të përcaktohet në mënyrë transparente, të dokumentuar dhe të mbështetur në kostot e nevojshme për ofrimin e shërbimit, kategorinë e shërbimit, nivelin e kompleksitetit dhe marzhin operacional të aplikueshëm.

Kjo metodologji zbatohet për shërbimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe për shërbimet e implementimit të masave të sigurisë kibernetike, në kuadër të operimit dhe administrimit të sistemeve TIK, në përputhje me vendimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë "ADS" sh.a.

2. Formula e përgjithshme e llogaritjes së pagesës

Pagesa për një shërbim llogaritet sipas formulës:

Pagesa = Kostoja e shërbimit të realizuar nga shoqëria "ADS" sh.a. + Marzhi operacional + Kostot e elementeve të siguruara nga palë të treta, kur ka të tilla

Për qëllim të kësaj metodologjie, marzhi operacional llogaritet sipas formulës:

Marzhi operacional = Kostoja e shërbimit të realizuar nga shoqëria "ADS" sh.a. × Përqindja e marzhit operacional të aplikueshëm, sipas nenit 8 të këtij vendimi.

Përqindja e marzhit operacional përcaktohet sipas matricës së parashikuar në nenin 8 të vendimit, e cila ndërthur kategorinë e vlerës financiare të shërbimit me nivelin e kompleksitetit, ndërsa për shërbimet e implementimit të masave të sigurisë kibernetike aplikohet marzhi operacional fiks prej 20%, sipas parashikimeve të nenit 8, të vendimit.

Për qëllim të kësaj metodologjie:

a) kostoja e shërbimit të realizuar nga shoqëria "ADS" sh.a., përfshin kostot direkte dhe indirekte që lidhen me veprimtarinë, burimet, kapacitetet dhe angazhimin e shoqërisë "ADS" sh.a. për ofrimin, garantimin, përmirësimin, sigurinë ose vazhdimësinë e shërbimit;

b) marzhi operacional është vlera që i shtohet kostos së shërbimit të realizuar nga shoqëria "ADS" sh.a., për mbulimin e rezervës së vazhdimësisë, riskut operacional, kostove të paparashikuara të lidhura me ofrimin e shërbimit, investimeve për rritjen e kapaciteteve dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë "ADS" sh.a.;

c) kostot e elementeve të siguruara nga palë të treta përfshijnë, sipas rastit, vlerën e mallrave, pajisjeve *hardware*, licencave *software*, platformave, produkteve, teknologjive, abonimeve ose shërbimeve të tjera të nevojshme për realizimin e shërbimit, të cilat nuk ofrohen drejtpërdrejt nga shoqëria "ADS" sh.a.;

ç) pagesa është vlera përfundimtare që rezulton nga mbledhja e kostos së shërbimit të realizuar nga shoqëria "ADS" sh.a., marzhit operacional të aplikueshëm dhe kostove të elementeve të siguruara nga palë të treta, kur ka të tilla.

Marzhi operacional aplikohet vetëm mbi koston e shërbimit të realizuar drejtpërdrejt nga "ADS" sh.a. dhe nuk aplikohet mbi kostot e elementeve të siguruara nga palë të treta.

Pagesa konkrete për çdo shërbim përcaktohet në kostimin përkatës të përgatitur nga shoqëria "ADS" sh.a. dhe pasqyrohet në kontratën e shërbimit dhe/ose marrëveshjen e nivelit të shërbimit.

3. Komponentët e kostos së shërbimit

Kostoja e shërbimit përfshin një ose disa nga komponentët e mëposhtëm, sipas natyrës, objektit dhe kushteve konkrete të shërbimit. Për efekt të aplikimit të marzhit operacional, dallohen kostot e shërbimit të realizuara drejtpërdrejt nga shoqëria "ADS" sh.a. dhe kostot e elementeve të siguruara nga palë të treta, mbi të cilat nuk aplikohet marzh operacional.

a) Kostoja e burimeve njerëzore të brendshme ose e ekspertizës së jashtme të angazhuar për ofrimin e shërbimit;

b) Kostoja e licencave, platformave, aplikacioneve, mjeteve dhe teknologjive të nevojshme;

c) Kostoja e infrastrukturës, hostimit, ruajtjes së të dhënave, *backup*-it, rikuperimit, vazhdimësisë dhe disponueshmërisë së shërbimit;

ç) Kostoja administrative, organizative dhe e menaxhimit të shërbimit;

d) Kostoja specifike për implementimin e masave të sigurisë kibernetike;

dh) Kostoja për trajnimin, orientimin ose transferimin e njohurive te përdoruesit dhe strukturat përgjegjëse të institucionit përfitues;

e) Kostoja e zhvillimit, përmirësimit, integrimit, migrimit, testimit, dokumentimit ose optimizimit;

ë) Kosto të tjera të nevojshme dhe të arsyetuara, që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin, garantimin, përmirësimin, sigurinë ose vazhdimësinë e shërbimit.

Komponentët e kostos përfshihen në llogaritjen e pagesës vetëm kur janë të lidhur drejtpërdrejt me natyrën, objektin dhe kushtet konkrete të shërbimit që do të ofrohet.

Çdo komponent kostoje dokumentohet në kostimin përkatës, në mënyrë që pagesa të jetë e verifikueshme dhe e auditueshme.

4. Përcaktimi i kostos së personelit

Kostoja e personelit llogaritet mbi bazën e burimeve njerëzore të angazhuara për realizimin e shërbimit.

Në përcaktimin e kostos së personelit merren në konsideratë:

a) numri i ekspertëve ose punonjësve të angazhuar;

b) profili, roli dhe niveli i ekspertizës së tyre;

c) koha e angazhimit në shërbim;

ç) pagesat, shtesat ose shpërblimet e lidhura drejtpërdrejt me angazhimin në shërbim;

d) kostot e tjera të lidhura me angazhimin e personelit, sipas akteve të brendshme të shoqërisë "ADS" sh.a.

Kur shërbimi llogaritet mbi bazën e kohës së angazhimit, kostoja e personelit mund të përcaktohet sipas formulës:

Kosto personeli = Numri i ekspertëve × Koha e angazhimit × Norma e kostos për njësi kohe

Për qëllim të kësaj pike, njësia e kohës mund të jetë orë, ditë, muaj ose njësi tjetër e përcaktuar në kostimin e shërbimit, sipas natyrës së angazhimit.

5. Kostot teknologjike, infrastrukturore dhe operacionale

Kostot teknologjike, infrastrukturore dhe operacionale përfshijnë kostot e nevojshme për sigurimin e mjeteve, platformave, infrastrukturës dhe kapaciteteve teknike, që mundësojnë ofrimin e shërbimit.

Këto kosto mund të përfshijnë, sipas rastit:

a) licenca *software*, platforma, aplikacione dhe mjete të specializuara;

b) mjete për zhvillim, testim, monitorim, raportim, automatizim, menaxhim kërkesash ose administrim teknik;

c) kapacitete infrastrukturore fizike dhe virtuale, pajisje *hardware* dhe pajisje mbështetëse, përfshirë servera, kapacitete përpunimi, ruajtje të dhënash, pajisje rrjeti, pajisje sigurie, ambiente virtuale, mjedise testimi dhe prodhimi;

ç) hostim, *backup*, rikuperim, vazhdimësi shërbimi dhe disponueshmëri;

d) komponentë teknikë, shërbime mbështetëse ose zgjidhje të tjera të nevojshme për realizimin e shërbimit;

dh) kosto të tjera të nevojshme dhe të arsyetuara, që lidhen drejtpërdrejt me sigurimin e kapaciteteve teknologjike, infrastrukturore ose operacionale për realizimin e shërbimit.

Kostot teknologjike, infrastrukturore dhe operacionale përfshihen në pagesë, kur janë të domosdoshme për ofrimin e shërbimit dhe dokumentohen në kostimin përkatës.

6. Kostot për implementimin e masave të sigurisë kibernetike

Kostot për implementimin e masave të sigurisë kibernetike në kuadër të operimit, administrimit, mirëmbajtjes ose përmirësimit të sistemeve TIK, përfshijnë kostot e nevojshme që lidhen me mbrojtjen, monitorimin, forcimin, testimin, vlerësimin, trajtimin e ngjarjeve ose incidenteve dhe përmirësimin e sigurisë së sistemeve, platformave, aplikacioneve ose infrastrukturave TIK.

Kostot e implementimit të masave të sigurisë kibernetike mund të përfshijnë, sipas rastit:

a) burime njerëzore të specializuara;

b) licenca, abonime, platforma, mjete dhe teknologji të specializuara të sigurisë kibernetike;

c) testime, vlerësime, konfigurime, përmirësime ose masa teknike sigurie;

ç) shërbime monitorimi, mbrojtjeje, reagimi, rikuperimi ose forcimi të sigurisë;

d) kosto për dokumentimin, standardizimin, pajtueshmërinë dhe zbatimin e masave të sigurisë;

dh) kosto të tjera të nevojshme dhe të arsyetuara, që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të sigurisë kibernetike.

Kostot për implementimin e masave të sigurisë kibernetike përfshihen në pagesë si pjesë e shërbimit të kërkuar, e dokumentacionit teknik dhe

funksional, e kontratës së shërbimit ose e marrëveshjes së nivelit të shërbimit.

Ofrimi i shërbimeve që lidhen me implementimin e masave të sigurisë kibernetike nga shoqëria "ADS" sh.a. bëhet në përputhje me këtë vendim dhe nuk cenon kompetencat e autoriteteve përgjegjëse për sigurinë kibernetike, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Klasifikimi i shërbimit për efekt të llogaritjes së pagesës

Për efekt të llogaritjes së pagesës dhe aplikimit të marzhit operacional, shërbimi klasifikohet mbi bazën e ndërthurjes së kategorisë financiare të shërbimit me nivelin e kompleksitetit të tij, në përputhje me nenin 7 të vendimit.

Kategoritë, sipas vlerës financiare të shërbimit, janë:

a) Kategoria I – shërbime me vlerë deri në 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) lekë;

b) Kategoria II – shërbime me vlerë mbi 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) lekë deri në 150.000.000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

c) Kategoria III – shërbime me vlerë mbi 150.000.000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë deri në 350.000.000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

ç) Kategoria IV – shërbime me vlerë mbi 350.000.000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

Niveli i kompleksitetit të shërbimit klasifikohet në katër nivele:

a) I ulët – shërbime rutinë, mirëmbajtje standarde ose ndërhyrje të kufizuara teknike;

b) Mesatar – shërbime që përfshijnë integrime të moderuara, zhvillime ose përmirësime funksionale të kufizuara apo ndërhyrje në sisteme ekzistuese;

c) I lartë – shërbime që përfshijnë integrime komplekse, migrim, arkitekturë të re teknike, zhvillime të rëndësishme ose sisteme me ndikim të lartë institucional;

ç) Shumë i lartë – shërbime që lidhen me sisteme, platforma ose infrastruktura TIK me ndikim të lartë institucional, operacional ose publik, me kërkesa të larta për vazhdimësi, siguri, disponueshmëri ose me transformim digjital në shkallë të gjerë.

Përcaktimi i nivelit të kompleksitetit të shërbimit kryhet nga shoqëria "ADS" sh.a., mbi bazën e faktorëve objektivë teknikë, funksionalë, operacionalë dhe të sigurisë, përfshirë, ndër të tjera:

a) kompleksitetin teknik e funksional;

b) volumin e përdoruesve, transaksioneve dhe të dhënave;

c) integrimet dhe varësitë teknike;

ç) kritikalitetin institucional dhe ndikimin në shërbime publike;

d) nivelin e sigurisë dhe ndjeshmërinë e të dhënave;

dh) nivelin e kërkuar të shërbimit, disponueshmërisë dhe reagimit;

e) kohëzgjatjen e angazhimit dhe burimet e nevojshme për realizimin e shërbimit.

Metodologjia e detajuar për përcaktimin e nivelit të kompleksitetit të shërbimeve, përfshirë faktorët, peshat, pragjet e pikëzimit dhe mënyrën e dokumentimit të vlerësimit, përcaktohet me akt të brendshëm të shoqërisë "ADS" sh.a., në përputhje me vendimin.

Niveli i kompleksitetit të shërbimit dokumentohet në kostimin përkatës dhe shërben, së bashku me kategorinë financiare të shërbimit, për përcaktimin e marzhit operacional të aplikueshëm sipas nenit 8 të vendimit.

Për shërbimet e implementimit të masave të sigurisë kibernetike, kur ato përbëjnë objektin kryesor të shërbimit ose ofrohen si shërbime të specializuara, aplikohet marzhi operacional fiks i përcaktuar në nenin 8 të vendimit.

8. Aplikimi i marzhit operacional

Marzhi operacional aplikohet si përqindje fikse mbi koston e shërbimit të realizuar drejtpërdrejt nga shoqëria "ADS" sh.a. Për shërbimet e përgjithshme TIK, marzhi përcaktohet sipas matricës që ndërthur kategorinë e vlerës financiare të shërbimit me nivelin e kompleksitetit, në përputhje me nenin 7 të vendimit.

Për shërbimet e implementimit të masave të sigurisë kibernetike, kur ato përbëjnë objektin kryesor të shërbimit ose ofrohen si shërbime të specializuara, aplikohet marzhi operacional fiks prej 20%.

Marzhi operacional nuk aplikohet mbi kostot e mallrave, pajisjeve, licencave, platformave, produkteve, teknologjive, abonimeve ose shërbimeve të palëve të treta, të cilat evidentohen veçmas në kostimin e shërbimit.

Matrica e marzhit operacional aplikohet, si më poshtë:

Kategoria/kompleksiteti	I ulët	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë
Kategoria I (deri 50 milionë lekë)	**8%**	**10%**	**13%**	**16%**
Kategoria II (50–150 milionë lekë)	**7%**	**9%**	**12%**	**15%**
Kategoria III (150–350 milionë lekë)	**6%**	**8%**	**11%**	**14%**
Kategoria IV (mbi 350 milionë lekë)	**5%**	**7%**	**10%**	**13%**

Marzhi operacional i aplikuar dokumentohet në kostimin e shërbimit.

9. Dokumentimi i kostimit

Për çdo shërbim, shoqëria "ADS" sh.a. përgatit kostimin përkatës, i cili dokumenton mënyrën e llogaritjes së pagesës.

Kostimi përmban, të paktën:

a) përshkrimin e shërbimit;

b) bazën dokumentare mbi të cilën është kryer vlerësimi;

c) komponentët kryesorë të kostos;

ç) nivelin e kompleksitetit të shërbimit;

d) kategorinë e shërbimit;

dh) marzhin operacional të aplikuar;

e) pagesën e përllogaritur;

ë) arsyetimin për elementet kryesore të kostimit.

Dokumentimi i kostimit shërben për transparencë, audituesshmëri dhe trajtim të njëjtë të shërbimeve të krahasueshme.

10. Rishikimi i kostimit

Kostimi i shërbimit mund të rishikohet kur, përpara lidhjes së kontratës ose gjatë zbatimit të saj, ndryshojnë elementet që kanë ndikuar në llogaritjen e pagesës.

Rishikimi mund të kryhet, ndër të tjera, kur:

a) ndryshon objekti ose fusha e shërbimit;

b) ndryshojnë kërkesat teknike, funksionale ose operacionale;

c) ndryshon niveli i kërkuar i shërbimit;

ç) shtohen funksionalitete, përdorues, integrime ose komponentë të rinj;

d) ndryshon niveli i riskut operacional ose kërkesat e sigurisë;

dh) ndryshojnë kostot kryesore të shërbimit;

e) ndryshojnë afatet, burimet ose kushtet e realizimit.

Çdo rishikim i kostimit dokumentohet dhe, kur sjell ndryshim të pagesës, reflektohet në kontratën e shërbimit dhe/ose marrëveshjen e nivelit të shërbimit, sipas rastit dhe me dakordësimin e palëve.

VENDIM
Nr. 370, datë 20.5.2026

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË DISA PASURIVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË ZONAT KADASTRALE 3866 DHE 2105, KASHAR, BASHKIA TIRANË

Adresa e Pasurisë: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K -1 , Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare __ (Akti Nr. __ , Dt. ____), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET , Nr. Identifikimi/NIPT ____ , Pjesa Takuese 0/100, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K -1 , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. 00000001, Datë: 01/06/2020

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: TË DHËNAT E PASURISË JANË PËRMIRËSUAR/PËRDITËSUAR SIPAS NENIT 64 TË LIGJIT 33/2012 NË DT.31.08.20182310

DREJTORI
Eni Sejdinaj

Elvana Elmazi — Digitally signed by: Elvana Elmazi, Date: 2026.03.11 01:16:14 +02'00'
Abla Gjermeni — Digitally signed by: Abla Gjermeni, Date: 2026.03.11 01:53:54 +02'00'
Eni Sejdinaj — Digitally signed by: Eni Sejdinaj, Date: 2026.03.11 03:57:47 +02'00'

Data e lëshimit 11/03/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2
Date: 2026/03/11 13:18:20 +02'00'
M52126454J20260311131813 48ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 3866 **KODI UNIK:** 3866140018

NUMRI PASURISË : 181/72 **INDEKSI HARTËS:** K-34-88-(248-D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



Aurel Kokici — Digitally signed by: Aurel Kokici, Date: 2026.04.02 08:00:46 +02'00'

Eni Sejdinaj — Digitally signed by: Eni Sejdinaj, Date: 2026.04.02 09:58:34 +02'00'

SH 1:2500

DREJTORI

Data e lëshimit __//__//____

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2
Date:2026/04/02 08:02:38 +02'00'
M52126454J2026040208023169014

SHPJEGUES
- PARCELA
- NDËRTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2105019142
(Nga ____ , Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2105 , Lloji i Pasurisë: ARE , Nr. i Pasurisë: 562/5 , Sipërfaqja Totale 3097 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)
Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-88-(248-D), Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K -1 , Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare __ (Akti Nr. __ , Dt. ____), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET , Nr. Identifikimi/NIPT SHTET , Pjesa Takuese 0/0, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia VORË , Rruga LUMA 03890058 , Ndërtesa Nr. 10 , SH/K 1 , Apartamenti Nr. __

Pronari: SHTET , Nr. Identifikimi/NIPT ____ , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K -1 , Apartamenti Nr. __

Pronari: SHTET , Nr. Identifikimi/NIPT ____ , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. 01576 , Datë: 23/05/2007

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00004271	16/04/2018		KJO PASURI OKUPOHET NGA HALIM DAJA			0		

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: 3705

DREJTORI
Eni Sejdinaj

Elvana Elmazi — Digitally signed by: Elvana Elmazi, Date: 2026.03.11 12:59:56 +02'00'
Abla Gjermeni — Digitally signed by: Abla Gjermeni, Date: 2026.03.11 02:23:13 +02'00'
Eni Sejdinaj — Digitally signed by: Eni Sejdinaj, Date: 2026.03.11 03:47:30 +02'00'

Data e lëshimit 11/03/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2
Date: 2026/03/11 12:35:40 +02'00'
M52126454J20260311123532 62ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	2105	KODI UNIK:	2105019142
NUMRI PASURISË:	562/5	INDEKSI HARTËS:	K-34-88-(248-D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI
Eni Sejdinaj

Abla Gjermeni — Digitally signed by: Abla Gjermeni Date: 2026.03.11 02:23:02 +02'00'

Eni Sejdinaj — Digitally signed by: Eni Sejdinaj Date: 2026.03.11 03:47:12 +02'00'

Data e leshimit 3/11/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2
Date:2026/03/11 14:08:04 +02'00'
M52126454J20260311140757131I4014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHPJEGUES
- PARCELA
- NDËRTESA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2105025072
(Nga ____ , Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2105 , Lloji i Pasurisë: ARE , Nr. i Pasurisë: 562/6 , Sipërfaqja Totale 2078 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)
Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-88-(248-D), Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K -1 , Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare __ (Akti Nr. __ , Dt. ____), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET , Nr. Identifikimi/NIPT ____ , Pjesa Takuese 0/100, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K -1 , Apartamenti Nr. __

Pronari: SHTET , Nr. Identifikimi/NIPT ____ , Pjesa Takuese 0/100, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. LN.2018 , Datë: 16/04/2018

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: 3706

DREJTORI
Eni Sejdinaj

Elvana Elmazi — Digitally signed by: Elvana Elmazi, Date: 2026.03.11 01:15:08 +02'00'
Abla Gjermeni — Digitally signed by: Abla Gjermeni, Date: 2026.03.11 01:54:37 +02'00'
Eni Sejdinaj — Digitally signed by: Eni Sejdinaj, Date: 2026.03.11 03:55:33 +02'00'

Data e lëshimit 11/03/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2
Date:2026/03/11 13:16:55 +02'00'
M52126454J20260311131647 45ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	2105	KODI UNIK:	2105025072
NUMRI PASURISË:	562/6	INDEKSI HARTËS:	K-34-88-(248-D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 1000

DREJTORI
Eni Sejdinaj

Abla Gjermeni — Digitally signed by: Abla Gjermeni Date: 2026.03.11 01:54:06 +02'00'
Eni Sejdinaj — Digitally signed by: Eni Sejdinaj Date: 2026.03.11 03:55:12 +02'00'

Data e leshimit 3/11/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2
Date:2026/03/11 13:51:21 +02'00'
M52126454J20260311135114541 4014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHPJEGUES
PARCELA
NDËRTESA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2105031095
(Nga 2105019140, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2105 , Lloji i Pasurisë: ARE , Nr. i Pasurisë: 562/15 , Sipërfaqja Totale 486 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)
Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-88-(248-D), Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K -1 , Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare __ (Akti Nr. URDHER 47, NR PROT 319 , Dt. 17/01/2025), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET , Nr. Identifikimi/NIPT ____ , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia ____ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K -1 , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme, Nr. URDHER 47, NR PROT 319 , Datë: 17/01/2025
Regjistruar: Nr. 7394 , Datë: 17/01/2025

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: Rrethi

DREJTORI
Eni Sejdinaj

Elvana Elmazi — Digitally signed by: Elvana Elmazi, Date: 2026.03.11 01:20:39 +02'00'
Abla Gjermeni — Digitally signed by: Abla Gjermeni, Date: 2026.03.11 01:51:59 +02'00'
Eni Sejdinaj — Digitally signed by: Eni Sejdinaj, Date: 2026.03.11 03:59:53 +02'00'

Data e lëshimit 11/03/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2
Date: 2026/03/11 13:22:53 +02'00'
M52126454J20260311132244 99ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	2105	KODI UNIK:	2105031095
NUMRI PASURISË:	562/15	INDEKSI HARTËS:	K-34-88-(248-D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 1000

DREJTORI
Eni Sejdinaj

Abla Gjermeni — Digitally signed by: Abla Gjermeni Date: 2026.03.11 01:51:44 +02'00'
Eni Sejdinaj — Digitally signed by: Eni Sejdinaj Date: 2026.03.11 03:59:40 +02'00'

Data e leshimit 3/11/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2
Date:2026/03/11 13:54:11 +02'00'
M52126454J20260311135404601014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHPJEGUES
PARCELA
NDËRTESA

VENDIM
Nr. 372, datë 20.5.2026 [1]

PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË TREGUT TË PRODUKTEVE TË PESHKIMIT E TË AKUAKULTURËS DHE PËR MIRATIMIN E FORMËS E TË PËRMBAJTJES SË PLANEVE TË PRODHIMIT E TË MARKETINGUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 61/1, pika 2/1, dhe 109, pika 4, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e organizimit e të funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit e të akuakulturës dhe të miratojë formën dhe përmbajtjen e planeve të prodhimit e të marketingut.

2. Organizimi i tregut të produkteve të peshkimit e të akuakulturës, këtu e në vijim "tregu", përbëhet nga elementet e mëposhtme:

a) Organizatat sipas pikës 53, të nenit 4, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar;

b) Standardet e marketingut;

c) Informacionet për konsumatorin;

ç) Rregullat e konkurrencës;

d) Informacionet mbi tregjet.

3. Organizatat e prodhuesve dhe organizatat ndërsektoriale mund të përfitojnë mbështetje financiare nga skema e masave mbështetëse të ministrisë.

Neni 2
Objektivat e organizimit të tregut

1. Organizimi i tregut për produktet e peshkimit e të akuakulturës krijohet, me qëllim që:

a) të kontribuojë në arritjen e objektivave për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare biologjike;

b) të mundësojë që industria e peshkimit dhe akuakulturës të zbatojë legjislacionin në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën;

c) të forcojë konkurrueshmërinë e industrisë së peshkimit dhe akuakulturës, në veçanti të prodhuesve;

ç) të përmirësojë transparencën dhe qëndrueshmërinë e tregjeve, në mënyrë të veçantë sa i përket njohurive ekonomike dhe njohjes së tregjeve të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës përgjatë zinxhirit të furnizimit;

d) të sigurojë që shpërndarja e vlerës së shtuar përgjatë këtij zinxhiri të jetë më e balancuar;

dh) të përmirësojë informimin e konsumatorit dhe ndërgjegjësimin e tij, përmes njoftimit dhe etiketimit që ofron informacion të kuptueshëm;

e) të kontribuojë në garantimin e kushteve të barabarta për të gjitha produktet e tregtuara, duke promovuar shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të peshkimit;

ë) të kontribuojë në sigurimin që konsumatorët të kenë një furnizim të larmishëm me produkte të peshkimit dhe akuakulturës;

f) të pajisë konsumatorin me informacion të verifikueshëm dhe të saktë, lidhur me origjinën e produktit dhe mënyrën e prodhimit të tij, veçanërisht nëpërmjet shënjimit dhe etiketimit.

2. Organizimi i tregut zbatohet për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, të listuara në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 3
Parimet e organizimit të tregut

Organizimi i tregut mbështetet në parimet e qeverisjes së mirë, si më poshtë vijon:

[1] Ky vendim përafron pjesërisht rregulloren nr. 1379/2013, e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 11 dhjetor 2013, "Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe të akuakulturës", për ndryshimin e rregulloreve të Këshillit (KE) nr. 1184/2006 dhe (KE) nr. 1224/2009 dhe për shfuqizimin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 104/2000, dhe plotësisht rregulloren nr. 1418/2013, të Komisionit, datë 17 dhjetor 2013, lidhur me planet e prodhimit dhe të marketingut, në përputhje me rregulloren (BE) nr.1379/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe të akuakulturës.

a) Përcaktimi i qartë i përgjegjësive në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar;

b) Marrja në konsideratë e veçorive rajonale, përmes një qasjeje rajonale;

c) Miratimi i masave menaxhuese, në përputhje me këshillat më të mira shkencore të disponueshme;

ç) Ndjekja e një politike afatgjatë;

d) Efikasiteti i kostove administrative;

dh) Përfshirja e palëve të interesuara në të gjitha fazat, nga konceptimi deri në zbatimin e masave menaxhuese;

e) Përputhshmëria me legjislacionin në fuqi të peshkimit dhe akuakulturës;

ë) Vlerësimi i ndikimit në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës në Shqipëri;

f) Transparenca në trajtimin e të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe vënia në dispozicion e të dhënave për institucionet shkencore, për institucione të tjera me interes shkencor ose administrimi, si dhe për përdorues të tjerë fundorë.

Neni 4
Përkufizimet

Të gjithë termat e përcaktuar në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar. Për efekt të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "**Hedhja në treg**", ofrimi për herë të parë i një produkti të peshkimit ose akuakulturës në tregun e brendshëm ose për eksport.

2. "**Ministria**", ministria përgjegjëse për peshkimin dhe akuakulturën.

3. "**Produkt akuakulture**", çdo organizëm ujor në çdo fazë të ciklit jetësor, si rezultat i çdo aktiviteti akuakulture ose nënproduktet e tyre.

4. "**Produkt peshkimi**", organizmat ujorë nga çdo aktivitet peshkimi ose nënproduktet e përfituara prej tyre, të listuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. "**Prodhues**", çdo person fizik ose juridik që përdor mjete prodhimi për të siguruar produkte peshkimi ose akuakulture, me qëllim tregtimin e tyre.

6. "**Sektori i peshkimit dhe akuakulturës**", sektori i ekonomisë që përfshin të gjitha aktivitetet e prodhimit, të përpunimit e të marketingut të produkteve të peshkimit ose akuakulturës.

7. "**Shitje me pakicë**", trajtimi ose përpunimi i ushqimit dhe magazinimi i tij në pikën e shitjes ose shpërndarjes për konsumatorin final, duke përfshirë terminalet e shpërndarjes, restorantet, magazinat e fabrikave, shërbimet institucionale të ushqimit, dyqanet, qendrat e shpërndarjes së supermarketeve dhe pikat e shitjes me shumicë.

8. "**Vendosja në treg**", çdo furnizim i një produkti të peshkimit ose akuakulturës për shpërndarje, konsum, përdorim të brendshëm ose për eksport, në kuadër të një aktiviteti tregtar, qoftë me pagesë apo falas.

9. "**Organizatë ndërsektoriale**", një organizatë e përbërë nga përfaqësues të një ose më shumë aktiviteteve ekonomike, të lidhura me prodhimin, përpunimin ose tregtimin e produkteve të peshkimit dhe akuakulturës, e krijuar për të promovuar koordinimin dhe zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANIZATAVE

Neni 5
Krijimi i organizatave të prodhuesve të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës

1. Organizatat e prodhuesve të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës, këtu e në vijim "organizatë e prodhuesve", krijohen me iniciativën e prodhuesve të produkteve të peshkimit ose akuakulturës, sipas nenit 62, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

2. Organizatat e prodhuesve themelohen duke respektuar parimin e përfshirjes së prodhuesve në shkallë të vogël dhe adresimit të nevojave të tyre specifike.

3. Një organizatë e prodhuesve, që përfaqëson aktivitetet e peshkimit, ose një organizatë e prodhuesve të akuakulturës mund të bashkohen dhe të krijohet si një organizatë e përbashkët e prodhuesve të peshkimit dhe akuakulturës.

Neni 6
Masat e marra nga organizatat prodhuese

1. Për të arritur objektivat e përcaktuar në nenin 61/1, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të

ndryshuar, organizatat e prodhuesve ndërmarrin masat e mëposhtme, për:

a) përshtatjen e prodhimit me kërkesat e tregut;

b) kanalizimin e furnizimit dhe marketingut të produkteve të anëtarëve të tyre;

c) promovimin e produkteve të peshkimit dhe akuakulturës të anëtarëve të tyre në një mënyrë jodiskriminuese, duke përdorur certifikimin dhe, në veçanti, emërtimet e origjinës, vulat e cilësisë, emërtimet gjeografike dhe specialitetet tradicionale;

ç) të siguruar që aktivitetet e anëtarëve të tyre janë në përputhje me rregullat e vendosura nga organizata përkatëse e prodhuesve;

d) promovimin e trajnimit profesional e të programeve të bashkëpunimit për të inkurajuar hyrjen e të rinjve në sektor;

dh) zvogëlimin e ndikimit mjedisor të peshkimit, përmes masave për përmirësimin e selektivitetit të pajisjeve të peshkimit;

e) promovimin e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit për të përmirësuar marketingun dhe çmimet;

ë) lehtësimin e aksesit të konsumatorëve në informacion mbi produktet e peshkimit e të akuakulturës.

2. Organizatat e prodhuesve të peshkimit përdorin edhe masat e mëposhtme për:

a) planifikimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të peshkimit të anëtarëve të tyre në mënyrë kolektive, në përputhje me menaxhimin e burimeve biologjike detare nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit, përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e masave për përmirësimin e selektivitetit të aktiviteteve të peshkimit dhe këshillimin me autoritetet kompetente;

b) shmangien dhe minimizimin e zënieve të padëshiruara përmes angazhimit në zhvillimin dhe zbatimin e masave teknike, si dhe përdorimin më të mirë të zënieve të padëshiruara të stoqeve tregtare, pa krijuar një treg për ato që janë nën madhësinë minimale të ruajtjes, në përputhje me *shtojcen III,* bashkëlidhur vendimit nr. 402, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det", i ndryshuar;

c) menaxhimin e magazinimit të përkohshëm për produktet e peshkimit, në përputhje me nenet 31 dhe 32, të këtij vendimi.

3. Organizatat e prodhuesve në akuakulturë përdorin edhe masat e mëposhtme, për:

a) nxitjen e aktiviteteve të qëndrueshme të akuakulturës, veçanërisht në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, shëndetit të kafshëve dhe mirëqenies së tyre;

b) mbledhjen e të dhënave mbi produktet e tregtuara, përfshirë të dhënat ekonomike mbi shitjet e para, si dhe planifikimin e prodhimit;

c) mbledhjen e të dhënave mjedisore;

ç) planifikimin e menaxhimit të aktiviteteve të akuakulturës të anëtarëve të tyre;

d) mbështetjen e programeve për profesionistët, me qëllim promovimin e produkteve të qëndrueshme të akuakulturës;

dh) menaxhimin e ruajtjes së përkohshme të produkteve të akuakulturës, në përputhje me nenet 31 dhe 32, të këtij vendimi.

Neni 7

Krijimi i shoqatave të organizatave të prodhuesve

1. Një shoqatë e organizatave të prodhuesve mund të krijohet me bashkimin e dy ose më shumë organizatave të prodhuesve, të njohura nga ministria, sipas ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

2. Rregullat e këtij vendimi, që zbatohen për organizatat e prodhuesve, zbatohen edhe për shoqatat e organizatave të prodhuesve.

Neni 8

Objektivat e shoqatave të organizatave të prodhuesve

Shoqatat e organizatave të prodhuesve ndjekin objektivat e mëposhtëm:

a) Kryerja në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme e objektivave të organizatave të prodhuesve, sipas legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën;

b) Koordinimi dhe zhvillimi i aktiviteteve me interes të përbashkët për organizatat e prodhuesve.

Neni 9

Krijimi i organizatave ndërsektoriale

Organizatat ndërsektoriale krijohen me iniciativën e operatorëve të produkteve të peshkimit e të akuakulturës dhe njihen sipas nenit 62, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

Neni 10
Objektivi i organizatave ndërsektoriale

Organizatat ndërsektoriale synojnë përmirësimin e koordinimit të kushteve për disponueshmërinë e produkteve të peshkimit dhe akuakulturës në tregun e brendshëm dhe për eksport.

Neni 11
Masat që zbatohen nga organizata ndërsektoriale

Për të arritur objektivin e përcaktuar në nenin 10, të këtij vendimi, organizata ndërsektoriale ndërmerr masat e mëposhtme, për:

a) hartimin e kontratave standarde për anëtarësimin në organizatë dhe për funksionimin e saj;

b) promovimin e produkteve shqiptare të peshkimit e të akuakulturës në mënyrë të integruar, duke përdorur certifikimin dhe, veçanërisht, emërtimet e origjinës, vulat e cilësisë, emërtimet gjeografike dhe specialitetet tradicionale;

c) përcaktimin e rregullave për prodhimin dhe marketingun e produkteve të peshkimit e të akuakulturës që janë më të ashpra se ato të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën;

ç) përmirësimin e cilësisë, të transparencës dhe të njohurive mbi prodhimin e tregun, si dhe realizimin e aktiviteteve profesionale e të trajnimit për çështje që lidhen me cilësinë, gjurmueshmërinë, sigurinë ushqimore dhe nxitjen e iniciativave kërkimore;

d) kryerjen e kërkimeve dhe studimeve të tregut, zhvillimin e teknikave për optimizimin e funksionimit të tregut, përmes përdorimit të teknologjive të informacionit e të komunikimit, si dhe mbledhjen e të dhënave socio-ekonomike;

dh) ofrimin e informacionit dhe realizimin e kërkimeve të nevojshme për të siguruar furnizime të qëndrueshme në sasi, cilësi dhe çmim, që përputhen me kërkesat e tregut dhe pritshmëritë e konsumatorëve;

e) promovimin te konsumatorët të specieve të zëna nga popullatat e peshkimit që janë në gjendje të qëndrueshme, që kanë vlera ushqimore dhe që nuk janë konsumuar gjerësisht;

ë) kontrollin dhe marrjen e masave për përputhshmërinë e aktiviteteve të anëtarëve të tyre me rregullat e vendosura nga organizata përkatëse ndërsektoriale.

Neni 12
Mbështetje financiare për organizatat e prodhuesve dhe për shoqatat e organizatave të prodhuesve

1. Masat e marketingut për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, të cilat synojnë krijimin e organizatave të prodhuesve ose të shoqatave të organizatave të prodhuesve, janë objekt i mbështetjes financiare nga skema e masave mbështetëse e ministrisë së bujqësisë.

2. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për skemat kombëtare të mbështetjes në bujqësi, peshkim dhe zhvillim rural, që miratohet çdo vit.

Neni 13
Funksionimi i brendshëm

Funksionimi i brendshëm i organizatave të prodhuesve dhe i organizatave ndërsektoriale bazohet në këto rregulla:

a) Përputhshmëria e anëtarëve me rregullat e miratuara nga organizata, në lidhje me shfrytëzimin e qëndrueshëm të peshkimit, prodhimit dhe marketingut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës;

b) Mosdiskriminimi ndërmjet anëtarëve;

c) Vendosja e një kontributi financiar nga anëtarët për të financuar veprimtarinë e organizatës;

ç) Funksionim demokratik, që garanton përfshirjen e anëtarëve në kontrollin dhe marrjen e vendimeve;

d) Vendosja e sanksioneve efektive, ndaluese dhe proporcionale për shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në rregulloren e brendshme, në veçanti, në rast të mospagesës së kontributeve financiare;

dh) përcaktimi i rregullave për pranimin e anëtarëve të rinj dhe për largimin nga anëtarësia;

e) përcaktimi i rregullave për mbajtjen e llogarive dhe për hartimin e buxhetit të nevojshëm për menaxhimin e organizatës.

Neni 14
Shpërndarja e mundësive të peshkimit

Në ushtrimin e funksioneve të saj, një organizatë e prodhuesve e njohur dhe që ka anëtarë të ndryshëm zbaton rregullat e parashikuara në

legjislacionin në fuqi për peshkimin, për shpërndarjen e mundësive të peshkimit midis anëtarëve, në përputhje me planet e menaxhimit në fuqi.

Neni 15
Zbatimi i rregullave të organizatës së prodhuesve

1. Me kërkesë të organizatës së prodhuesve, ministri mund të vendosë që rregullat e detyrueshme të miratuara brenda një organizate të prodhuesve, të zbatohen edhe nga prodhues që nuk janë anëtarë të saj, por që shesin ndonjë nga produktet përkatëse brenda zonës në të cilën organizata e prodhuesve është përfaqësuese, me kusht që:

a) organizata e prodhuesve të jetë themeluar prej të paktën një viti dhe të konsiderohet përfaqësuese e prodhimit dhe marketingut, përfshirë edhe sektorin e peshkimit artizanal;

b) rregullat të kenë lidhje me ndonjë nga masat për organizatat e prodhuesve të përcaktuara, në:

i. shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 1, të nenit 6, të këtij vendimi;

ii. shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 6, të këtij vendimi;

iii. shkronjat "a" deri në "d", të pikës 3, të nenit 6, të këtij vendimi.

c) të zbatohen rregullat e konkurrencës sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Për qëllimet e shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, një organizatë e prodhuesve në sektorin e peshkimit konsiderohet përfaqësuese kur ajo përfaqëson të paktën 55 % të sasisë së tregtuar të produktit përkatës gjatë vitit të kaluar, në zonën ku propozohet të zbatohen rregullat edhe për prodhuesit që nuk janë anëtarë.

3. Për qëllimet e shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, një organizatë e prodhuesve në sektorin e akuakulturës konsiderohet përfaqësuese kur ajo përfaqëson të paktën 40 % të sasisë së tregtuar të produktit përkatës gjatë vitit të kaluar, në zonën ku propozohet të zbatohen rregullat edhe për prodhuesit që nuk janë anëtarë.

4. Rregullat që zbatohen edhe për joanëtarët janë në fuqi për një periudhë nga 2 muaj deri në 12 muaj.

Neni 16
Zbatimi i rregullave të organizatave ndërsektoriale

1. Me kërkesë të organizatës ndërsektoriale, ministri mund të vendosë që rregullat e detyrueshme, të miratuara nga një organizatë ndërsektoriale, të zbatohen edhe nga operatorë që nuk janë pjesë e saj, me kusht që:

a) organizata ndërsektoriale të mbulojë të paktën 65 % të secilës prej të paktën dy nga këto veprimtari: prodhimi, përpunimi ose tregtimi i produktit përkatës gjatë vitit të kaluar, në zonën ose zonat përkatëse;

b) rregullat, që parashikohen të zbatohen për operatorët e tjerë, të përfshijnë të paktën një nga masat e përcaktuara në pikat 1 deri në 7, të nenit 11, të këtij vendimi, dhe të mos shkaktojnë dëm për operatorët e tjerë që veprojnë në të njëjtën zonë.

2. Rregullat, që zbatohen për operatorët joanëtarë të organizatës ndërsektoriale, kanë kohëzgjatje maksimale tre vjet, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 4, të nenit 18, të këtij vendimi.

Neni 17
Përgjegjësia

Kur rregullat zbatohen ndaj subjekteve joanëtare të organizatës, në përputhje me nenet 15 dhe 16, të këtij vendimi, ministria, me kërkesë të organizatës, mund të vendosë që këto subjekte të paguajnë financiarisht ndaj organizatës së prodhuesve ose organizatës ndërsektoriale për ekuivalentin e të gjithë ose të një pjese të kostove që janë paguar nga anëtarët, si rezultat i zbatimit të rregullave që shtrihen edhe mbi subjektet joanëtare.

Neni 18
Procedura për zgjatjen e rregullave

1. Organizata njofton ministrinë për rregullat që vendosin të bëjnë të detyrueshme për të gjithë prodhuesit ose operatorët, anëtarë dhe joanëtarë në zonën ose zonat specifike, në përputhje me nenet 15 dhe 16, të këtij vendimi.

2. Ministria miraton zgjatjen e rregullave të parashikuara në pikën 1, me kusht që:

a) të respektohen parashikimet e neneve 15 dhe 16, të këtij vendimi;

b) të respektohen rregullat e konkurrencës sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës;

c) zgjatja të mos rrezikojë tregtinë e lirë.

3. Ministri miraton ose refuzon kërkesën e organizatës për zbatimin e rregullave brenda 1 muaji nga marrja e kërkesës.

4. Organizata e prodhuesve ose ndërsektoriale njofton ministrinë të paktën 1 (një) muaj para përfundimit të periudhës fillestare. Në rast se ministri miraton periudhën shtesë ose nuk paraqet kundërshtim brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës, zbatimi i rregullave vazhdon të mbetet në fuqi për periudhën e zgjatur.

Neni 19
Revokimi i miratimit

1. Ministri revokon miratimin për zbatimin e rregullave në rast se konstatohet se ndonjë nga kërkesat e këtij kreu nuk është përmbushur.

2. Ministria njofton me shkrim organizatat dhe operatorët joanëtarë për vendimin e revokimit të miratimit.

KREU III
PLANI I PRODHIMIT DHE MARKETINGUT TË ORGANIZATAVE TË PRODHUESVE

Neni 20
Plani i prodhimit dhe marketingut

1. Çdo organizatë e prodhuesve harton një plan prodhimi dhe tregtimi për speciet kryesore të saj për tregtim. Ky plan ka për qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar në nenin 2, të këtij vendimi, dhe objektivat e përcaktuar në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin" të ndryshuar.

2. Plani i prodhimit dhe marketingut përmban:

a) një program prodhimi për speciet e zëna ose të kultivuara;

b) një strategji tregtimi që përshtatet me sasinë, cilësinë dhe furnizimin sipas kërkesave të tregut;

c) masat që merren nga organizata e prodhuesve për të përmbushur objektivat e saj;

ç) masa të veçanta për rregullimin e furnizimit me specie që kanë vështirësi në tregtim gjatë vitit;

d) penalitete për anëtarët që shkelin vendimet e miratuara për zbatimin e planit përkatës.

3. Organizata e prodhuesve zbaton planin e prodhimit dhe marketingut pas miratimit nga ministri.

4. Organizata e prodhuesve mund të rishikojë planin e prodhimit dhe marketingut, dhe e zbaton pas miratimit nga ministri.

5. Organizata e prodhuesve përgatit një raport vjetor të aktiviteteve të saj, në kuadër të planit të prodhimit dhe marketingut, dhe e paraqet për miratim te ministri.

6. Çdo organizatë e prodhuesve siguron në planet e prodhimit dhe të tregtimit, të paraqitura në përputhje me pikën 1, të këtij neni, që zbarkimi i organizmave detarë nën madhësinë minimale të referencës për ruajtjen të mos çojë në zhvillimin e aktiviteteve të destinuara posaçërisht për zënien e këtyre organizmave detarë.

7. Ministria kryen kontrolle për të siguruar që çdo organizatë e prodhuesve përmbush detyrimet e parashikuara në këtë nen. Mosrespektimi edhe vetëm të një detyrimi mund të rezultojë në revokimin e njohjes.

Neni 21
Forma dhe struktura e planeve të prodhimit dhe marketingut

Forma dhe struktura e planit të prodhimit dhe marketingut është sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ministri nxjerr udhëzim mbi detajimin e mëtejshëm të planit të prodhimit dhe marketingut.

Neni 22
Afatet dhe procedura për dorëzimin e planeve

1. Çdo organizatë e prodhuesve, brenda tetë javëve nga njohja e saj nga ministri, dorëzon planin e prodhimit e të marketingut pranë ministrisë dhe planet pasuese duhet të paraqiten të paktën tetë javë para përfundimit të vlefshmërisë së planeve ekzistuese.

2. Ministria vlerëson planin e paraqitur nga organizata e prodhuesve dhe miraton planin brenda gjashtë javëve nga data e dorëzimit të tij, duke njoftuar organizatën e prodhuesve.

3. Në rast se ministria vlerëson se objektivat e përcaktuar në nenin 2, të këtij vendimi, dhe në nenin 61/1, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të

ndryshuar, nuk përmbushen nga plani i paraqitur, njofton organizatën e prodhuesve, brenda 6 (gjashtë) javëve. Organizata e prodhuesve dorëzon planin e ndryshuar brenda dy javëve.

4. Afati për miratimin e planit të ndryshuar është katër javë nga data e dorëzimit të tij.

Neni 23
Rishikimi i planeve

1. Nëse ministria vlerëson se një plan i ndryshuar, i paraqitur në përputhje me pikën 4, të nenit 28, të këtij vendimi, synon të arrijë objektivat e përcaktuar në nenin 2, të këtij vendimi, dhe në nenin 61/1, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, miraton planin brenda katër javëve nga data e dorëzimit dhe njofton menjëherë organizatën e prodhuesve.

2. Nëse ministri vlerëson se objektivat nuk mund të arrihen nga plani i ndryshuar, ajo njofton organizatën përkatëse brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Organizata dorëzon një plan të ndryshuar brenda dy javëve.

3. Afati për miratimin e planit të ndryshuar është katër javë nga data e dorëzimit të tij.

KREU IV
STANDARDET E MARKETINGUT

Neni 24
Përcaktimi i standardeve të marketingut

1. Standarde të marketingut për produktet e peshkimit të destinuara për konsum njerëzor, të listuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, përcaktohen pa marrë parasysh origjinën e tyre, vendase ose të importuara.

2. Standardet e marketingut lidhen me cilësinë, madhësinë, peshën, paketimin, prezantimin ose etiketimin e produkteve dhe, në veçanti, me:

a) madhësitë minimale të marketingut, duke marrë parasysh kështillat më të mira shkencore të disponueshme. Këto madhësi minimale të marketingut përkojnë me madhësitë minimale të referencës për ruajtje, në përputhje me shtojcën III, bashkëlidhur vendimit nr. 402, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det";

b) specifikimet e produkteve të ruajtura, në përputhje me kërkesat e ruajtjes dhe detyrimet ndërkombëtare.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen pa cenuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për ushqimin dhe për peshkimin.

Neni 25
Përputhshmëria me standardet e marketingut

1. Produktet e destinuara për konsum njerëzor, për të cilat janë përcaktuar standarde të marketingut, mund të bëhen të disponueshme në tregun e brendshëm vetëm në përputhje me këto standarde.

2. Të gjitha produktet e peshkimit të zbarkuara, përfshirë ato që nuk përputhen me standardet e marketingut, mund të përdoren për qëllime të tjera përveç konsumit njerëzor, duke përfshirë ushqimin për kafshë, prodhimin e vajit të peshkut, ushqimet për kafshë shtëpiake, shtesat ushqimore, produktet farmaceutike ose kozmetike.

KREU V
INFORMACIONET PËR
KONSUMATORIN DHE PËR TREGJET

Neni 26
Informacioni i detyrueshëm

1. Produktet e peshkimit e të akuakulturës, të listuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "e", të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi, të cilat tregtohen në tregun e brendshëm, pa marrë parasysh origjinën ose metodën e marketingut, mund të ofrohen për shitje për konsumatorin përfundimtar ose për institucione që përdorin produktin, si shkolla, spitale, mensa ushtarake, kantina fabrikash, burgje, konvikte studentore, institucione publike ose private vetëm nëse, përveç rregullave të parashikuara në kreun VI, të vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim", i ndryshuar, etiketimi përmban edhe:

a) emrin tregtar dhe emrin shkencor të species;

b) metodën e prodhimit, duke përcaktuar shprehjet "… i zënë …", "… i zënë në ujëra të ëmbla …" ose "… i kultivuar …";

c) zonën ku produkti është zënë ose kultivuar, si dhe kategorinë e veglave të peshkimit të përdorura në zënien e peshqve, sipas shtojcës II, të vendimit nr. 402, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det", të ndryshuar;

ç) nëse produkti është shkrirë;

d) datën e jetëgjatësisë minimale, kur është e nevojshme.

2. Kërkesa e shkronjës "ç", të pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohet për:

a) përbërësit e pranishëm në produktin përfundimtar;

b) ushqimet për të cilat ngrirja është një hap teknologjikisht i nevojshëm në procesin e prodhimit;

c) produktet e peshkimit e të akuakulturës të ngrira më parë për qëllime të sigurisë shëndetësore;

ç) produktet që janë shkrirë para procesit të tymosjes, kripjes, gatimit, marinimit, tharjes ose një kombinimi të ndonjërit nga këto procese.

3. Për produktet e peshkimit e të akuakulturës të paketuara, informacioni i detyrueshëm i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të jepet për shitjen me pakicë përmes informacionit tregtar si reklamat ose posterat.

4. Kur një produkt i përzier ofrohet për shitje për konsumatorin përfundimtar ose për institucione dhe përbëhet nga i njëjti lloj specieje, por që vjen nga metoda të ndryshme prodhimi, specifikohet metoda për çdo ngarkesë. Kur një produkt i përzier përmban të njëjtin lloj specieje nga zona të ndryshme të zënies ose prodhimit, specifikohet zona e ngarkesës më të përfaqësuar në sasi, së bashku me një tregues që produktet vijnë nga zona të ndryshme të zënies ose kultivimit.

5. Ministria mund të përjashtojë nga këto kërkesa sasi të vogla produktesh të shitura drejtpërdrejt nga anijet e peshkimit tek konsumatorët, nëse vlera e tyre nuk kalon 5 000 lekë.

6. Produktet e peshkimit dhe akuakulturës dhe paketimet e tyre që nuk përputhen me këtë nen mund të tregtohen vetëm deri në përdorimin e stokut ekzistues.

Neni 27
Emri tregtar

1. Organizata harton dhe publikon një listë me emrat tregtarë për produktet peshkore në territorin e saj të veprimit, së bashku me emrat shkencorë përkatës. Lista përmban:

a) emrin shkencor për çdo specie, në përputhje me Sistemin e Informacionit *FishBase* ose me sistemin Informativ për Shkencat Ujore dhe Peshkimin (ASFIS) të Organizatës për Ushqimin dhe Bujqësinë, këtu e në vijim FAO;

b) emrin tregtar që përmban:

i. emrin e specieve në gjuhën zyrtare; ose

ii. çdo emër tjetër ose emra që janë të pranuar ose të lejuar në nivel vendor ose rajonal.

2. Të gjitha speciet e peshkut, që janë përbërës të një ushqimi tjetër, emërtohen si "peshk", me kusht që emri dhe prezantimi i këtij ushqimi të mos i referohet një specieje të veçantë.

3. Çdo ndryshim në listën e emrave peshkorë tregtarë të pranuar nga organizata i njoftohet menjëherë ministrisë.

Neni 28
Treguesi i zonës së zënies ose prodhimit

1. Treguesi i zonës së zënies ose prodhimit, në përputhje me shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 26, përbëhet nga:

a) në rastin e produkteve të peshkimit të zëna në det, emri i nënzonës ose ndarjeve të listuara në zonat e peshkimit të FAO-së, si dhe emri i kësaj zone, i shprehur në terma të kuptueshëm për konsumatorin, ose një hartë apo piktogram që tregon atë zonë; si përjashtim, për produktet e peshkimit, të zëna në ujëra të tjera, përveç Atlantikut të Veriut (Zonë Peshkimi FAO 27) dhe Detit Mesdhe dhe Detit të Zi (Zonë Peshkimi FAO 37), mund të tregohen vetëm emrat e zonave të peshkimit të FAO-s;

b) në rastin e produkteve të peshkimit të zëna në ujëra të ëmbla, një referencë për zonën e prejardhjes së produktit;

c) në rastin e produkteve të akuakulturës, një referencë për vendin ku produkti ka arritur më shumë se gjysmën e peshës së tij përfundimtare ose ka qëndruar për më shumë se gjysmën e periudhës së kultivimit. Në rastin e molusqeve, vendi ku ka

kaluar një fazë përfundimtare të kultivimit ose ka qëndruar të paktën gjashtë muaj.

2. Përveç informacionit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, operatorët mund të tregojnë një zonë më të saktë të zënies ose prodhimit.

Neni 29
Informacioni shtesë

1. Përveç informacionit të detyrueshëm, të kërkuar në përputhje me nenin 26, të këtij kreu, mund të ofrohet informacion shtesë, me kusht që të jetë i qartë dhe i saktë, si më poshtë vijon:

a) data e zënies së produkteve të peshkimit ose data e vjeljes së produkteve të akuakulturës;

b) data e zbarkimit të produkteve të peshkimit ose informacion mbi portin ku janë zbarkuar produktet;

c) informacion më i detajuar mbi llojin e veglave të peshkimit, sipas shtojcës VI, bashkëlidhur vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim", i ndryshuar;

ç) në rastin e produkteve të peshkimit të zëna në det, detaje mbi shtetin flamur të anijes që i ka zënë produktet;

d) informacion mjedisor;

dh) informacion etik ose social;

e) informacion mbi teknikat dhe praktikat e prodhimit;

ë) informacion mbi përbërjen ushqyese të produktit.

2. Informacioni i listuar në pikën 1, të nenit 26, të këtij vendimi, mund të përfshihet edhe në një kod elektronik (*QR code*) që përfshin një pjesë ose të gjithë informacionin.

3. Informacioni shtesë nuk duhet të reduktojë hapësirën e disponueshme për informacionin e detyrueshëm në etiketim.

4. Asnjë informacion shtesë nuk mund të përfshihet nëse nuk mund të verifikohet.

Neni 30
Informacioni mbi tregjet

1. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit e të akuakulturës:

a) mbledh, analizon dhe shpërndan njohuri ekonomike dhe informacion për tregun e brendshëm të produkteve të peshkimit e të akuakulturës përgjatë zinxhirit të furnizimit;

b) ofron mbështetje praktike për organizatat e prodhuesve dhe organizatat ndërsektoriale për të përmirësuar koordinimin e informacionit midis operatorëve dhe përpunuesve;

c) kryen anketa të rregullta mbi çmimet e produkteve të peshkimit dhe akuakulturës në tregun e brendshëm përgjatë zinxhirit të furnizimit dhe bën analiza për tendencat e tregut;

ç) kryen studime të përkohshme për tregun dhe siguron metodologji për anketa, lidhur me formimin e çmimeve.

2. Për zbatimin e pikës 1 të këtij neni, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës merr masat e mëposhtme:

a) Lehtëson qasjen në të dhënat e disponueshme për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, të mbledhura në përputhje me legjislacionin e peshkimit;

b) Siguron që informacioni mbi tregun, përfshirë anketat mbi çmimet, analizat dhe studimet e tregut, të jetë i disponueshëm për të gjitha palët e interesuara dhe për publikun në mënyrë të aksesueshme dhe të kuptueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për informimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Organizatat kontribuojnë në arritjen e objektivave të përmendur në pikat e mësipërme.

KREU VI
STABILIZIMI I TREGJEVE

Neni 31
Mekanizmi i ruajtjes së produkteve të peshkimit dhe akuakulturës

Organizatat e prodhuesve në sektorin e peshkimit e të akuakulturës përfitojnë mbështetje financiare për ruajtjen e produkteve të listuara në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi, të cilat tregtohen brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, nëse plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) Produktet janë vendosur në treg nga organizatat e prodhuesve dhe për to nuk është siguruar blerës në çmimin kufi, të përcaktuar në nenin 32 të këtij vendimi;

b) Produktet përmbushin standardet e përbashkëta të marketingut, të vendosura në

përputhje me nenin 24, të këtij vendimi, dhe janë të përshtatshme për konsum njerëzor;

c) Produktet janë trajtuar ose përpunuar dhe ruhen në tanke ose kafaze, nëpërmjet metodave të ngrirjes (në bord të anijeve ose në impiante tokësore), kriposjes, tharjes, marinimit, ose, kur është e përshtatshme, nëpërmjet zierjes dhe pasterizimit, pavarësisht nëse produktet janë filetuar, prerë në copa apo u janë hequr kokat;

ç) Produktet e akuakulturës nuk mbahen në ruajtje në gjendje të gjallë;

d) Produktet rikthehen në treg për konsum njerëzor pas përfundimit të periudhës së ruajtjes;

dh) Produktet qëndrojnë në ruajtje për një periudhë minimale prej 5 ditësh kalendarike;

e) Kriteret dhe procedurat për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për skemat kombëtare të mbështetjes në bujqësi, peshkim dhe zhvillim rural, që miratohet çdo vit.

Neni 32
Çmimet kufi për aktivizimin e mekanizmit të ruajtjes

1. Para fillimit të çdo viti kalendarik, çdo organizatë e prodhuesve mund të paraqesë në mënyrë individuale një propozim për çmimin kufi që aktivizon mekanizmin e ruajtjes, të përmendur në nenin 31, të këtij vendimi, për produktet e listuara në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Çmimi kufi nuk mund të tejkalojë 80 % të çmimit mesatar të ponderuar, të regjistruar për produktin përkatës në zonën e veprimtarisë së organizatës përkatëse të prodhuesve, gjatë tri viteve të fundit që paraprijnë vitin për të cilin caktohet çmimi kufi.

3. Në përcaktimin e çmimit kufi merren në konsideratë këto elemente:

a) Zhvillimet në prodhim dhe kërkesë;

b) Stabilizimi i çmimeve në treg;

c) Rregullimi i tregjeve;

ç) Të ardhurat e prodhuesve;

d) Interesat e konsumatorëve.

4. Ministria, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga organizatat e prodhuesve të njohura në Republikën e Shqipërisë, përcaktojnë çmimet kufi që do të zbatohen nga këto organizata. Këto çmime përcaktohen mbi bazën e kritereve të përmendura në pikat 2 dhe 3, të këtij neni dhe bëhen publike.

KREU VII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 33
Inspektimi dhe mbikëqyrja e organizatave të prodhuesve të peshkimit dhe akuakulturës

1. Ministria, nëpërmjet strukturave të inspektimit të peshkimit, ushtron kontrollin dhe mbikëqyrjen periodike të organizatave të prodhuesve në peshkim dhe akuakulturë, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së tyre me dispozitat e këtij vendimi dhe të legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën.

2. Inspektimi përfshin, ndër të tjera, verifikimin e elementeve të mëposhtme:

a) Përmbushjen e kritereve të njohjes dhe të kushteve të përcaktuara për statutin e organizatës së prodhuesve;

b) Respektimin e rregullave të funksionimit të brendshëm, të miratuara nga vetë organizata;

c) Zbatimin e planeve të prodhimit dhe marketingut, si dhe të masave për arritjen e objektivave të qëndrueshmërisë;

ç) Respektimin e standardeve të gjurmueshmërisë, cilësisë dhe sigurisë ushqimore;

d) Zbatimin e masave mjedisore dhe të rregullave për mbrojtjen e burimeve peshkore dhe të mjedisit ujor.

3. Organizatat e prodhuesve janë të detyruara të bashkëpunojnë me organet inspektuese dhe t'u vënë në dispozicion dokumentacionin, të dhënat dhe informacionin e kërkuar, si dhe të lejojnë hyrjen në ambientet e tyre për qëllime kontrolli dhe inspektimi.

4. Në rast të konstatimit të shkeljeve, organet e caktuara me funksione inspektimi në këtë fushë ndërmarrin masa administrative, në përputhje me legjislacionin për peshkimin dhe akuakulturën, duke përfshirë:

a) paralajmërimin dhe detyrimin për korrigjim brenda një afati të caktuar;

b) pezullimin e përkohshëm të statusit të organizatës së prodhuesve;

c) revokimin e njohjes, në rast të shkeljeve të rënda ose të përsëritura.

Neni 34
Institucionet që ngarkohen

Ngarkohen ministria përgjegjëse për peshkimin, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit e të akuakulturës dhe inspektorati që mbulon peshkimin për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 35
Shfuqizime me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian

Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian të gjitha dispozitat e këtij vendimi shfuqizohen.

Neni 36
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

SHTOJCA I
PRODUKTET E PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS QË MBULOHEN NGA ORGANIZATAT

Kodi NK		**Përshkrimi**
a)	0301	Peshk i gjallë:
	0302	Peshk, i freskët apo i ftohtë, përjashto filetot e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut, të kreut 0304:
	0303	Peshk, i ngrirë, përjashto filetot e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut, të kreut 0304;
	0304	Fileto peshku dhe mish tjetër peshku (nëse është apo jo i grirë), i freskët, i ftohtë apo i ngrirë;
b)	0305	Peshk, i tharë, i kripur apo në ujë me kripë; peshk i tymosur, nëse është gatuar apo jo më parë apo gjatë procesit të tymosjes;
c)	0306	Kafshët guackore të nënujshme, nëse janë apo jo në guackë, të gjalla, të freskëta, të ftohta, të ngrira, të thara, të kripura apo në ujë me kripë; kafshët guackore të nënujshme të tymosura nëse janë ose jo në guaskë, nëse janë ose jo të gatuara përpara ose gjatë procesit të tymosjes; kafshët guackore të nënujshme, në guackë, të gatuara nga avulli apo nga zierja në ujë, nëse janë apo jo të ftohta, të ngrira, të thara, të kripura apo në ujë me kripë;
	0307	Molusqet, nëse janë apo jo në guackë, të gjalla, të freskëta, të ftohta, të ngrira, të thara, të kripura apo në ujë me kripë; molusqe të tymosura, nëse janë ose jo në guaskë, nëse janë ose jo të gatuara përpara ose gjatë procesit të tymosjes;
d)	0511 0511 91	Produktet me origjinë prej kafshëve të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; kafshët e ngordhura, të kapitullit 1 apo 3, të papërshtatshme për konsum njerëzor;
		Të tjera;
		Produkte të peshkut apo të kafshëve guackore të nënujshme, molusqeve apo kafshëve të tjera jovertebrore ujore; kafshë të ngordhura, të kapitullit 3;
	0511 91 10	Mbetje peshku;
	0511 91 90	Të tjera;
e)	1212	Leshterikët dhe alga të tjera;
f)	1504	Dhjamëra dhe vajra, dhe fraksionet e tyre, të peshkut apo të gjitarëve detarë, nëse janë apo jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht;
	1504 10	Vajra të mëlçive të peshkut dhe fraksionet e tyre;
	1504 20	Vajrat dhe dhjamërat dhe fraksionet e tyre, të peshkut, ndryshe nga vajrat e mëlçive;

g)	1603 00	Ekstraktet dhe lëngjet e mishit, peshkut apo krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jovertebrore ujore;
h)	1604	Peshk i përgatitur apo i konservuar; havjar dhe zëvendësuesit e havjarit të përgatitur prej vezëve të peshkut;
i)	1605	Krustacet, molusqet dhe kafshë të tjera jovertebrore ujore, të përgatitur apo të konservuar;
j)	1902	Brumërat nëse janë apo jo të gatuara apo të mbushura (me mish apo me substanca të tjera) apo të përgatitura ndryshe, të tilla si spageti, makarona, makarona pete, lasanjë, gnocchi, ravioli, kaneloni; couscous nëse janë apo jo të përgatitura;
	1902 20	Brumëra të mbushura, nëse janë apo jo të gatuara apo të përgatitura ndryshe;
	1902 20 10	Që përmbajnë më shumë se 20 % ndaj peshës peshk, krustacë, molusqe apo kafshë të tjera ujore jovertebrore;
k)	2301	Miellrat, kokrrizat dhe sferat, të mishit apo të brendshmeve të mishit, të peshkut apo të krustaceve, molusqeve dhe kafshëve të tjera jovertebrore ujore, të papërshtatshme për konsum njerëzor; zhigla;
	2301 20 00	Miellrat, kokrrizat dhe sferat, të peshkut apo të krustaceve, molusqeve apo të kafshëve të tjera jovertebrore ujore;
l)	2309	Përgatitjet e një lloji të përdorur në ushqimin e kafshëve;
	2309 90	Të tjera;
	ex 2309 90 10	Të tretshme peshku apo të gjitarëve detarë.

SHTOJCA II
PRODUKTET E PESHKIMIT QË I NËNSHTROHEN MEKANIZMIT TË RUAJTJES

Kodi NK	**Përshkrimi**
0301 94	Ton me fletë notuese blu i Atlantikut dhe Paqësorit (*Thunnus thunnus*)
0302 21 10	Rumbë "Lesser" apo Greenland (*Reinhardtius hippoglossoides*)
0302 22 00	Gjuhëz (*Pleuronectes platessa*)
0302 23 00	Sole (*Solea spp.*)
0302 29 10	Megrim (*Lepidorhombus spp.*)
0302 31	Ton i bardhë apo me fletë notuese të gjata (*Thunnus alalunga*)
0302 31 90	Ton i bardhë apo me fletë notuese të gjata – të tjera (*Thunnus alalunga*)
0302 32	Ton me fletë notuese të verdha (*Thunnus albacares*)
0302 33	Ton Skipjack (Bonito me bark vija-vija) (*Katsuëonus pelamis*)
0302 35	Ton me fletë notuese blu i Atlantikut dhe Paqësorit (*Thunnus thunnus*)
0302 35 19	Specie të tjera të tonit të familjes *Thunnus*
0302 41 00	Harrenga (*Clupea harengus, Clupea pallasii*)
0302 43 10	Sardele (*Sardina pilchardus*)
0302 43 90	Sprat (*Sprattus sprattus*)
0302 44 00	Skumbri (*Scomber scombrus, S. australasicus, S. japonicus*)
0302 51	Merluc (*Gadus morhua, Gadus ogac, Gadus macrocephalus*)
0302 52 00	Merluc (*Melanogrammus aeglefinus*)
0302 53 00	Merluc i Alaskës (*Pollachius virens*)
0302 59 30	Pollack (*Pollachius pollachius*)
0302 69 81	Të tjera (peshq të freskët/të ftohtë)
0302 81 15	Peshkaqen Picked (*Squalus acanthias*) dhe *cat sharks* (*Scyliorhinus spp.*)

Kodi NK	Përshkrimi
0302 82 00	Rreze dhe skate (*Rajidae*)
0302 85	Koce (*Sparidae*)
0302 85 10	Koce (*Dentex dentex* ose *Pagellus spp.*)
0302 85 90	Koce (*Sparidae*) – të tjera
0302 89 31	Peshk i kuq (*Sebastes spp.*, *Sebastes marinus*)
0302 89 40	Krap i rrezeve (*Brama spp.*)
0303 29 00	Conger (*Conger conger*) dhe ngjala të tjera
0303 55	Jack dhe horse mackerel (*Trachurus spp.*)
0303 57 00	Peshk shpatë (*Xiphias gladius*)
0303 66	Hake (*Merluccius spp., Urophycis spp.*)
0303 68 10	*Whiting blu* (*Micromesistius poutassou*)
0303 69 30	Whiting (*Merlangius merlangus*)
0303 69 80	Ling (*Molva spp.*)
0304 74	Merluc (*Merluccius spp., Urophycis spp.*)
0304 83	Peshq të rrafshët (*Pleuronectidae, Bothidae, Soleidae*, etj.)
0304 83 30	Shojzë, ushojzë e zezë (*Platichthys flesus*)
0304 95	Peshq të familjeve *Gadidae, Merlucciidae, Macrouridae*, etj.
0304 99 65	Peshku majmun/Monkfish (*Lophius spp.*)
0305 54 50	Açuge (*Engraulis spp.*)
0306 14 30	Gaforre (*Cancer pagurus*)
0306 15 00	Gaforre e detit të Norvegjisë (*Nephrops norvegicus*)
0306 16	Karkaleca të ujërave të ftohta dhe gaforre (*Pandalus spp., Crangon crangon*)
0306 17	Karkaleca dhe gaforre – kategori
0306 17 91	Karkalec i kuq i thellësisë (*Parapenaeus longirostris*)
0306 17 92	Karkaleca të llojit *Penaeus*
0306 17 93	Karkaleca të familjes *Pandalidae* (të tjerë)
0306 17 94	Karkaleca të llojit *Crangon* (të tjerë)
0306 17 99	Karkaleca dhe gaforre – të tjera
0307 22 10	*Coquilles* St. Jacques (*Pecten maximus*)
0307 42 10	Sepie (*Sepia officinalis, Rossia macrosoma, Sepiola spp.*)
0307 42 20	*Loligo spp.*
0307 42 30	Kallamar (*Ommastrephes, Loligo, Nototodarus, Sepioteuthis spp.*)
0307 43	Sepie – të ngrira
0307 43 21	Sepie *lesser* (*Sepiola rondeleti*)
0307 43 25	Sepie – të tjera
0307 43 92	*Illex spp.*
0307 51 00	Oktapod (*Octopus spp.*)

SHTOJCA III
FORMA DHE STRUKTURA E PLANEVE TË PRODHIMIT DHE MARKETINGUT

SEKSIONI 1
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI ORGANIZATËN E PRODHUESVE

- Emri;
- Lloji;
- Kodi i identifikimit;
- Vendndodhja;
- Numri i anëtarëve;
- Qarkullimi vjetor (i detajuar sipas specieve);
- Vëllimi i kapjeve ose i prodhimit (i detajuar sipas specieve).

SEKSIONI 2
PROGRAMI I PRODHIMIT DHE STRATEGJIA E MARKETINGUT

Ky seksion përfshin një kalendar orientues të furnizimit dhe përshkruan mënyrën se si do të sigurohet përshtatshmëria e furnizimit me kërkesat e tregut, në lidhje me cilësinë, sasinë dhe paraqitjen, veçanërisht për speciet kryesore që tregtohen.

SEKSIONI 3
MASAT PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË PËRCAKTUAR NË NENIN 61/1, TË LIGJIT NR. 64/2012, "PËR PESHKIMIN", TË NDRYSHUAR

Ky seksion përshkruan, ndër të tjera, masat përkatëse të parashikuara në nenin 6 të këtij vendimi të cilat organizata e prodhuesve synon t'i zbatojë për të arritur objektivat e ndryshëm, të përcaktuar në nenin 61/1, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

SEKSIONI 4
MASAT PËR PËRSHTATJEN E FURNIZIMIT PËR DISA SPECIE

Ky seksion përshkruan, ndër të tjera, masat përkatëse të parashikuara në nenin 6 të këtij vendimi, të cilat organizata e prodhuesve synon t'i zbatojë për të përshtatur furnizimin për ato specie që zakonisht paraqesin vështirësi në tregtim gjatë vitit.

SEKSIONI 5
MASAT NDËSHKUESE DHE MASAT E KONTROLLIT

Ky seksion përfshin një përshkrim të masave ndëshkuese që aplikohen për llojet e ndryshme të shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit të planeve të prodhimit dhe marketingut. Për më tepër, mund të përshkruhen edhe masat përkatëse të parashikuara në nenin 6 të këtij vendimi, të cilat organizata e prodhuesve synon t'i zbatojë për të garantuar kontrollin dhe përputhshmërinë e veprimtarive të anëtarëve të saj me rregullat e vendosura.

VENDIM
Nr. 373, datë 20.5.2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 335, DATË 6.6.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN, TË PROCEDURËS DHE KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 19, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 3.23, të pikës 3, të kreut I, shtohet pika 3.24, me këtë përmbajtje:

"3.24 "Përdorim i vogël" nënkupton përdorimin e një produkti për mbrojtjen e bimëve në Shqipëri, të caktuar në bimë ose produkte bimore, të cilat janë:

a) jo të kultivuara gjerësisht në Shqipëri; ose

b) të kultivuara gjerësisht për të përmbushur një nevojë të jashtëzakonshme për mbrojtjen e bimëve.";

b) Pas shkronjës "ç", të pikës 5.4, të kreut II, shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) zgjerimin për përdorimet e vogla, pas paraqitjes së të dhënave, sipas pikave 6 dhe 7, të kreut VI, të këtij vendimi.";

c) Pas pikës 5, të kreut VI, shtohen pikat 6, 7, 8, 9 dhe 10, me këtë përmbajtje:

"6. Aplikanti ose mbajtësi i dokumentit të regjistrimit, institucionet zyrtare ose shkencore, të përfshira në aktivitetet bujqësore ose organizatat/shoqatat profesionale bujqësore ose përdoruesit profesionistë, mund të kërkojnë që regjistrimi i një PMB-je të regjistruar të shtrihet në përdorime të vogla, që nuk mbulohen nga ai regjistrim.

7. Regjistrimi zgjerohet në përdorime të vogla, me kusht që:

a) përdorimi i synuar është i vogël në natyrë;

b) zgjerimi është në interes të publikut;

c) dokumentacioni dhe informacioni për të mbështetur zgjerimin e përdorimit është dorëzuar nga personat ose nga organet e përmendura në pikën 6, të këtij kreu, veçanërisht, të dhënat mbi nivelin e mbetjeve dhe, kur është e nevojshme, për vlerësimin e riskut për operatorin, punonjësin dhe kalimtarin.

8. Kur miratohet një zgjerim për përdorim të vogël, ministria përgjegjëse për bujqësinë, nëse është e nevojshme, informon aplikantin ose mbajtësin e dokumentit për regjistrim dhe i kërkon atij të ndryshojë etiketimin, në përputhje me rrethanat.

Në rast se aplikanti ose mbajtësi i dokumentit për regjistrim refuzon ta bëjë këtë, ministria përgjegjëse për bujqësinë siguron informimin e përdoruesve nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të ministrisë, duke përfshirë edhe udhëzimet specifike për përdorim.

9. Publikimi zyrtar sipas pikës 8, të këtij vendimi ose aty ku është e aplikueshme, etiketa duhet të përmbajë një referencë për përgjegjësinë e personit që përdor PMB-në, lidhur me dështimet për efikasitetin ose fitotoksicitetin e PMB-së, për të cilin është dhënë përdorimi i vogël.

10. Zgjerimi i përdorimit të vogël shënohet veçmas në etiketë dhe i referohet më vete kufizimeve të përgjegjësisë për efikasitetin ose fitotoksicitetin e PMB-së.";

ç) Pika 3, e kreut IX, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

URDHËR
Nr. 271, datë 20.5.2026

PËR DELEGIMIN E AUTORITETIT/KOMPETENCAVE NËPUNËSVE TË LARTË CIVILË TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike"; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, për plotësimin e detyrave funksionale, i delegohen kompetencat dhe autoriteti i titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me:

a) Lëshimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim jashtë vendit të punonjësve të aparatit të Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me nënndarjen "i", të shkronjës "a", të pikës 3, të vendimit nr. 870/2011, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit";

b) Transferimin pa pagesë të aktiveve nga Ministria e Drejtësisë tek institucionet e varësisë dhe anasjelltas, si dhe nga Ministria e Drejtësisë tek Njësitë e Sektorit Publik dhe anasjelltas;

c) Ushtrimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Drejtësisë, në zbatim të nenit 2, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", me përjashtim të kryerjes së procedurave të prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, nën 100 000 lekë;

d) Ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e të gjitha letërkërkesave për jashtë shtetit dhe nga jashtë shtetit që i përkasin juridiksionit të përgjithshëm, dhe të posaçëm penal dhe të kërkesave për informacion plotësues, në kuadër të çështjeve të ekstradimit, transferimit dhe njohjeve të vendimeve penale, për jashtë shtetit dhe nga jashtë shtetit, përveç vendimmarrjes mbi kërkesat për transferim, si dhe njohjen e vendimeve penale dhe civile;

e) Ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë Drejtësisë, sipas nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

2. Urdhri i ministrit të Drejtësisë nr. 170, datë 19.3.2026, "Për delegimin e autoritetit/kompetencave nëpunësve të lartë civile të Ministrisë së Drejtësisë", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu

VENDIM
Nr. 17, datë 19.5.2026

PËR ANËTARËSIMIN E DEGËS SË BANKËS SË HUAJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË "DEGA E BANKËS TÜRKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S., ALBANIA" NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 2, pika 1, të nenit 19, nenit 22, pika 5 dhe pika 6, të nenit 23, të nenit 52, pika 1, shkronja "p" dhe të nenit 53, pika 5, shkronja "d", të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 7, pika 2 dhe pika 3, të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014, "Për sigurimin e depozitave në banka", të ndryshuar; të nenit 7, pika 4, të Statusit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018; të nenit 18, pika 2, të rregullores "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave", të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 3.11.2014, si dhe me propozim të drejtorit të përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Anëtarësimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë "Dega e Bankës Türkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" në skemën e sigurimit të depozitave, si dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave.

2. Autorizohet kryetari i Këshillit Drejtues dhe drejtori i përgjithshëm për nënshkrimin e certifikatës për sigurimin e depozitave në degën e bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë "Dega e Bankës Türkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania".

3. Autorizohet drejtori i përgjithshëm për njoftimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë "Dega e Bankës Türkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave dhe për dorëzimin e certifikatës për sigurimin e depozitave, si dhe të informojë Autoritetin Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

5. Ngarkohet Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Donald Duraj

KËRKESË
Nr. 100/10, datë 20.5.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i linjës

110 kV Fier–Kafaraj dhe vendosja e traktit të ri në nënstacionin Fier"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "arë", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 173,647.31 (njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë pikë tridhjetë e një) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I LINJËS 110 kV FIER–KAFARAJ DHE VENDOSJA E TRAKTIT TË RI NË NËNSTACIONIN FIER"

Nr. rendor	Nr. shtylle	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE					VLERESIMET PËR SHPRONESIM														SHËNIME					ADRESA
											ARE			KULLOTE			TRUALL			TOKE PYJORE									
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqe shtylle (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	Nr. dok.	Data e regjistrimit	Tipi	Përshkrim i veçantë	Seksionet C, D & E të kartelës së pasurisë	
		A	B	C	Ç	D	DH	E	F	F	L	LL	M	N	Nj	O	P	Q	R	RR	S	SH	T	TH	U	X	XH	Y	Z
1	Nst.	Republika e Shqipërisë			Drize	1557	190/9	Truall	29808	439.90			-			-	439.90	0	-				-	00679	22.6.2016			Seksioni D – Nr. dok. 00679, datë regjistrimi 22.6.2016, ne administrim te OST sh.a.	Njësia Administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier
2	1	Dafina Zoi Lida Stefan	Sotir Tili Tili Tili	Bare Bare Golemi Bare	Drize	1557	250/55	Arë	3400	128.50	128.50	269	34,566.50										34,566.50	001036	Në AMTP i referohet pasurisë 250/53		Njësia Administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier		Njësia Administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier
3		Nuk ka informacion			Drize	1557	250/88			58.00														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier
4	2	Nuk ka informacion			Drize	1557	249/39			81.62						-								9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier
5	3	Dajlan Flutura	Dano Hamza	Dhiari Dhiari	Drize	1557	317/122	Arë	5156	6.00	6.00	269	1,614.00										1,614.00	00562			Njësia Administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier		Njësia administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier
6		Skender	Dano	Dhiari	Drize	1557	317/123	Arë	4562	58.00	58.00	269	15,602.00										15,602.00	00531			Njësia Administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier		Njësia administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier
7	4	Nuk ka informacion			Drize	1557	317/180			64.00			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier
8	5	Nuk ka informacion			Drize	1557	317/145			91.07			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Qendër/Fshati Drizë/ Bashkia Fier
9	6	Nuk ka informacion			Peshtan i Vogël	2939	382			64.00			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
10		Nuk ka informacion			Peshtan i Vogël	2939	29			11.57														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
11	7	Nuk ka informacion			Peshtan i Vogël	2939	139			91.07			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
12	8	Nuk ka informacion			Peshtan i Vogël	2939	139			66.00			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
13	9	Nuk ka informacion			Peshtan i Madh	2938	138			36.44			-			-								9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia administrative Levan/Fshati Peshtan i

																												Madh/Bashkia Fier
14		Nuk ka informacion	Peshtan i Vogël	2939	137/5			35.70			-			-								9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
15	10	Nuk ka informacion	Peshtan i Vogël	2939	129/11			37.00			-			-								9508	11.12.2025		Shkresa nr./prot. 9508 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
16		Nuk ka informacion	Peshtan i Vogël	2939	129/10			29.00			-			-								9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
17	11	Nuk ka informacion	Peshtan i Madh	2938	x			167.88			-			-								9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
18	12	Nuk ka informacion	Peshtan i Vogël	2939	192			87.24			-			-								9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
19	13	Lako Bektash Fejzulla Malko Bektash Fejzulla Vezire Bektash Kapllanaj Nevrie Bektash Kandarxhi Fejzi Bektash Fejzulla Mine Bektash Tahiraj Kujtim Zenel Metaj Vasil Zenel Metaj Dashmir Zenel Metaj Hanko Demo Fejzulla Shezai Mustafa Fejzulla Gezime Mustafa Loshi Lindita Grigor Karavoqiri Lindita Mustafa Hasaj Merita Mustafa Mehmetaj Myftar Dule Fejzulla Zaim Dule Fejzulla Qazime Dule Fejzulla Dashamir Jashar Dacaj Edmond Jashar Dacaj Mamude Dule Fejzulla Mervin Isat Brahimaj Adriana Isat Brahimaj Lumturi Isat Çako Albert Isat Brahimaj Elisabeta Isat Musaraj Liljana Isat Kola Valdet Isat Deliallkasi Luftetar Mustafa Yzeiraj Drita Gjysho Kapaj Dallendyshe Gjysho Belshi Ahmet Gjysho Fejzulla Artjan Gjysho Fejzulla Arben Gjysho Fejzulla Zamira Gjysho Zarka Nexhmedin Osmen Fejzulla Luan Osmen Fejzulla Myzafer Osmen Fejzulla Violeta Osmen Nako Bujar Osmen Fejzulla Melaize Osmen Shahaj Dhurata Osmen Bardhi Zana Osmen Sadikaj Ilir Brahim Feejzulla Irena Brahim Hajderaj Rezarta Brahim Llano Altin Brahim Fejzulla	Peshtan i Vogël	2939	85/2	Pyll	246000	87.24			-			-				87.24	125	10,905.00	10,905.00	00243			Njësia Administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier		Njësia administrative Levan/Fshati Peshtan i Vogël/Bashkia Fier
20	14	Shtet	Bregas	1273	6641	Kullotë	39758899	66.00				66.00	0	-							-	000951	11.6.2025		Duke iu referuar shkresës nr. 9508 prot. Pasuria nr. 5953, ZK 1273 sipas hartës kadastrale, i është ndryshuar Nr. pas. në 6641, sipas kartelës, si		Njësia Administrative Frakull/Fshati Bregas/Bashkia Fier

																									rrjedhojë e ndarjes së pasurisë. Ndarja nuk është pasqyruar në hartën kadastrale		
21	15	Nuk ka informacion			Bregas	1273	47			66.00			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Bregas/Bashkia Fier
22	16	Nuk ka informacion			Bregas	1273	24			1.00			-			-								9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Bregas/Bashkia Fier
23		Nuk ka informacion			Bregas	1273	46			22.00			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Bregas/Bashkia Fier
24		Nuk ka informacion			Bregas	1273	49			129.70			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Bregas/Bashkia Fier
25	17	Nuk ka informacion			Levan	2436	219			101.94			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Levan/Bashkia Fier
26	18	Nuk ka informacion			Levan	2436	219			72.65			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Levan/Bashkia Fier
27	19	Nuk ka informacion			Levan	2436	219			83.63			-											9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Levan/Bashkia Fier
28	20	Kalem	Xhevit	Hila	Frakull e Madhe	1634	6/136	Arë	2598	9.00	9.00	269	2,421.00										2,421.00	Akti 1995			Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
29		Sali Liri Jolanda Blerina Sanie Saimir	Xhevit Xhevit Sali Sali Sali Sali	Hilaj Hilaj Hilaj Hilaj Hilaj Hilaj	Frakull e Madhe	1634	6/137	Arë	5400	100.92	100.92	269	27,147.48										27,147.48	001290			Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
30	21	Vangjel	Sotir	Bregu	Frakull e Madhe	1634	5/29	Arë	5150	67.28	67.28	269	18,098.32										18,098.32	00514	I referohet pasurisë 5/83 sipas AMTP-së		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
31		Sokrat	Kozma	Rushi	Frakull e Madhe	1634	5/30	Arë	1700	2.00	2.00	269	538.00										538.00	Akti 8962	I referohet pasurisë 5/81 sipas AMTP		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
32	22	Nuk ka informacion			Levan	2436	256/9			83.24														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Levan/Fshati Levan/Bashkia Fier
33	23	Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	1/32			6.00														9508	11.12.2025		Shkresa nr./prot. 9508 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
34		Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	1/33			180.51														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
35	24	Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	1/12			79.63														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
36	25	Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	1/35			79.63														9508	11.12.2025		Shkresa nr./prot. 9508 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e

																													Madhe/Bashkia Fier
37	26	Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	77/16			54.63														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
38		Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	77/17			25.00														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
39	27	Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	77/32			43.63														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
40		Feta	Muhamet	Meta	Frakull e Madhe	1634	77/33	Arë	7000	36.00	36.00	269	9,684.00										9,684.00	Akti. 9066			Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
41	28	Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	81/4			22.00														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
42		Virjon	Skendo	Skendaj	Frakull e Madhe	1634	81/5	Arë	8554	22.00	22.00	269	5,918.00										5,918.00	00422			Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
43		Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	149			35.63														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
44	29	Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	95/1			85.83														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
45	30	Bektash	Hysen	Xholi	Frakull e Madhe	1634	96/17	Arë	2602	73.69	73.69	269	19,822.61			-		-		-			19,822.61	Akti. 8985			Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
46		Nuk ka informacion			Frakull e Madhe	1634	96/21			9.00														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Frakull e Madhe/Bashkia Fier
47	31	Dhurim	Meleq	Hasani	Kafaraj	2022	161/12	Arë	3420	44.50	44.50	269	11970.5										11,970.50	00274	Duke ju referuar shkresës nr./prot. 9381 ASHK Fier pasuria mëmë nr. 161 nuk është ndarë në hartë, vetëm në kartela.		Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier
48		Xhezmi	Dane	Hasani	Kafaraj	2022	161/13	Arë	5690	44.50	44.50	269	11970.5										11,970.50	Akti. 11994	11.5.1991				Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier
49	32	Nuk ka informacion			Kafaraj	2022	12/10			93.79														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier
50		Kujtim	Muhamet	Tano	Kafaraj	2022	12/11	Arë	5560	12.60	12.60	269	3389.4										3,389.40	Akti. 12116			Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier

51	**33**	Nuk ka informacion	Kafaraj	2022	12/2			141.50														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier
52	**34**	Nuk ka informacion	Kafaraj	2022	10/9			72.19														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier
53		Nuk ka informacion	Kafaraj	2022	10/10			10.50														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier
54	**35**	Nuk ka informacion	Kafaraj	2022	14/2			176.51														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier
55		Nuk ka informacion	Kafaraj	2022	14/3			10.00														9381	4.12.2025		Shkresa nr./prot. 9381 ASHK Fier		Njësia Administrative Frakull/Fshati Kafaraj/Bashkia Fier
Shuma								**3804.86**	**604.99**		**162,742.31**	**66.00**		**-**	**439.90**			**87.24**		**10,905.00**	**173,647.31**						

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. (11-2026-2363) 468, datë 17.4.2026, vendosi shpalljen të zhdukur nga data 18.10.1995, të shtetasit Sotir Papaspiro, i lindur më 20.7.1928, me atësi Andon dhe amësi Veno, lindur në Nivan, Gjirokastër, dhe banues ne Durrës si dhe caktimin si kujdestar të pasurisë së tij, shtetasin Artur Karruli.

KËRKESË

Shtetasi Reis Gockaj kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, deklarimin të vdekur të shtetasit Leonard Gockaj më datë 18.11.1993, me atësi Reis dhe amësi Ervehe, i lindur më 14.7.1965, në Vlorë.

KËRKUES
Reis Gockaj

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 107|Datë: 26.05.2026 15:22:03 +02:00|cda472eb-df22-407c-a885-44bce5abab8d

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)